

FËMIJËT TANË

Udhëzues praktik për
prindër dhe mësime dhënë

Gusht 2017

Fëmijët tanë

Udhëzues praktik për prindër dhe mësime dhënë

Autorë:

Krenare Lleshi dhe Veton Sylhasi

Dizajni

Envinion

Botuar nga:

Qendra për Arsim e Kosovës

Deklarata e përgjegjësisë: Ky manual u hartua në kuadër të projektit “Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijës”, që financohet nga Bashkimi Evropian, menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës në partneritet me Forum ZFD. Përmbajtja e këtij manuali është përgjegjësi e organizatave zbatuese dhe në asnjë rrethanë nuk i atribuohet donatorit.

Përmbajtja

Informatë hyrëse	5
1. Të drejtat e njeriut	8
1.1 Karakteristikat e të drejtave të njeriut	8
1.2 Zhvillimi evolutiv i të drejtave të njeriut	10
1.3 Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut	11
2. Të drejtat e fëmijëve.....	13
2.1 Specifikat e fëmijëve.....	13
2.2 Nevoja për të trajtuar veçanërisht të drejtat e fëmijëve	14
2.3 Vështrim historik i trajtimit të të drejtave të fëmijëve	15
2.4 Të drejtat e fëmijës sipas vështrimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës	16
2.5 Forma e Konventës	17
2.6 Përmbajtja e Konventës.....	18
2.7 Konventa si burim i politikave globale	20
3. Mjedisi mik për fëmijën.....	23
3.1 Ndikimi i mjedisit social dhe marrëdhënieve sociale në zhvillimin e fëmijës	23
3.2 Kujdesi dhe edukimi i bazuar në të drejtat e fëmijës	25
3.3 Përfshirja e palëve të ndryshme në edukimin e fëmijës.....	27
3.4 Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijës si pjesë e mjedisit mik për fëmijë.....	30
3.5 Komuna mike për fëmijë.....	35
3.6 Shkollat mike për fëmijë	37

4. Fuqizimi i fëmijëve përmes pjesëmarrjes	39
4.1 Koncepti i pjesëmarrjes	39
4.2 Pjesëmarrja e fëmijëve në shkollë	42
4.3 Organizatat e nxënësve	43
4.4 Përfshirja e prindërve në shkollë si stimulim për pjesëmarrjen e fëmijëve.....	45
4.5 Pjesëmarrja e fëmijëve në bashkëpunimin familje – shkollë	47
5. Ide për veprim	49
6. Shembuj të praktikave të mira.....	62
7. Burime informimi.....	66
8. Karakteristikat e shkollës mike të bazuar në të drejtat e fëmijëve	78
9. Të reflektojmë rreth shkollës.....	80
10. Përmbledhje e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.....	82

Informatë hyrëse

Fëmijët dhe të rriturit janë të njëjtë në aspektin që të dy grupet janë qenie njerëzore që posedojnë të gjitha karakteristikat dhe mundësitë që janë të qenësishme për njeriun. Sidoqoftë, ata janë të ndryshëm në nivelin e zhvillimit të këtyre mundësive dhe karakteristikave. Fëmijët ende nuk i kanë zhvilluar aftësitë e veta plotësisht. Atyre u nevojitet një udhëheqje nga të rriturit.

Fëmijët janë qenie njerëzore që janë në fazën e zhvillimit fizik, kognitiv, social dhe emocional. Si të tillë, ata kanë nevoja të veçanta që nuk i kanë njerëzit tjerë. Sepse duke qenë qenie njerëzore jo krejtësisht të pjekura fizikisht dhe emocionalisht, fëmijët nuk mund të gëzojnë të gjitha të drejtat që u takojnë, pa pasur ndihmën e të rriturve dhe kujdesin e shtuar të shtetit. Këto fakte u japin të drejtave të fëmijës një dimension tjetër dhe një specifike në raport me të drejtat e njeriut.

Zhvillimi i fëmijëve nuk mund të bëhet pa i gëzuar të gjitha të drejtat e njeriut, prandaj të rriturit duhet të kujdesen që këto të drejta të gëzohen nga fëmijët në cilësinë më të mirë të mundshme. Ata vet duhet të marrin përgjegjësi në këtë drejtim dhe të ndërveprojnë me fëmijët në atë mënyrë që përmes vet këtij ndërveprimi fëmijët të njohin të drejtat e tyre, të fitojnë shkathtësi për t'i praktikuar ato dhe të krijojnë qëndrime që demonstrojnë sjellje të qytetarisë demokratike. Të gjitha ndërmarrjet në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duhet të bëhen me përfshirjen e fëmijëve. Pra, shteti përmes institucioneve dhe shoqëria duhet të punojë për fëmijët dhe me fëmijët.

Ky udhëzues është hartuar në kuadër të projektit “Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve” që financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, në partneritet me Forum Ziviler Friedensdienst e.V. – forum ZFD. Projekti ka për qëllim *t’i fuqizojë*

komunitetet lokale për të përmirësuar masat e mbrojtjes së fëmijëve në shkollë përmes ndërmjetësimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve.

Familja dhe shkolla janë vendet ku fëmijët e kalojnë pjesën më të madhe të kohës. Prandaj është shumë e rëndësishme që në radhë të parë prindërit, anëtarët tjerë të familjes dhe mësime dhënësit të kenë njohuri, shkathtësi e vlera për të promovuar e mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Ky udhëzues është hartuar me qëllim që t'u ofrohen informata prindërve dhe mësime dhënëseve, por edhe publikut të gjerë në lidhje me të drejtat e fëmijëve, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, ndërveprimin e suksesshëm me fëmijë, ofrimin e mundësive për fëmijët që të marrin pjesë aktivisht në jetën familjare e shkollore, si dhe në vendimmarrje për çështjet që lidhen me ta.

Udhëzuesi në pjesën e parë përmban informacion bazë për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve, shtjellon parimet, formën dhe përmbajtjen e Konventës dhe tregon rëndësinë e krijimit të mjedisit mik për fëmijë, kudo duke filluar nga familja e tutje. Kjo pjesë ngërthehet me këshilla praktike për lexuesit, me vegëza në materiale tjera elektronike që përforcojnë informacionin, por edhe me përvoja të autorëve lidhur me aspektet e shtjelluara.

Në pjesën tjetër të udhëzuesit, janë dhënë:

- disa ide për veprim që mund të shfrytëzohen qoftë në shkollë nga mësime dhënësit (ose mësime dhënësit bashkë me prindërit), qoftë në shtëpi nga prindërit e të afërmit e tjerë të rritur të fëmijëve;
- disa praktika të mira nga projekte të ndryshme në botë, në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
- një përmbledhje e burimeve për t'u shfrytëzuar nga prindërit, mësime dhënësit, por edhe të tjerët në punën e tyre me fëmijë. Disa prej

këtyre burimeve janë në dispozicion në gjuhën shqipe, ndërsa të tjerat në gjuhën angleze dhe janë lehtë të zbatueshme në kontekstin e përditshëm;

- një formë e vlerësimit të shkollës në këndvështrim të mjedisit mik për fëmijët, që u shërben prindërve e mësime dhënëseve, por edhe menaxhmentit të shkollave për të reflektuar për situatën në shkollë dhe për të nisur masa për përmirësimin e promovimit dhe mbrojtjes së mirëqenies së fëmijës në shkollë;
- një përmbledhje e tekstit të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, që u shërben lexuesve si pikë referente e vazhdueshme gjatë ndërveprimit me fëmijët dhe gjatë angazhimit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Mbetemi me shpresë që materiali që keni para vetes të shndërrohet në stimulim për ju për të përmirësuar praktikën personale dhe për të kontribuar në vetëdijësimin e njerëzve përreth për nevojën e ruajtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve dhe krijimin e një mjedisi miqësor dhe jo të dhunshëm për fëmijët!

“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me frymë vëllazërimi”.

(Neni 1 i DUDNj).

1. Të drejtat e njeriut

Të drejtat e njeriut janë norma të përgjithshme morale, që burojnë nga natyra njerëzore dhe i adresohen marrëdhënies shoqërore. Ato përgjithësisht mund të definojnë si të drejta që janë të qenësishme për natyrën tonë dhe pa të cilat ne si qenie njerëzore nuk mund të jetojmë. Si të tilla, të drejtat e njeriut na mundësojnë të shfrytëzojmë dhe zhvillojmë inteligjencën, shkathtësitë, talentin dhe vetëdijen tonë, dhe në këtë mënyrë të plotësojmë nevojat tona fizike dhe shpirtërore.

Dinjiteti i njeriut është në themelin e idesë së të drejtave të njeriut. Kjo më së miri është pasqyruar në nenin 1 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut e cila u shpall nga OKB më 10 dhjetor 1948.

1.1 Karakteristikat e të drejtave të njeriut

Të drejtat e njeriut kanë disa veti apo karakteristika të cilat e qartësojnë natyrën e tyre. Ato janë:

Universale dhe të patjetërsueshme - Në njërin anë, universaliteti i të drejtave të njeriut ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë, ngjyrës, pozitës shoqërore, etj. Kjo është arsyeja që ndalimi i diskriminimit është futur në Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut (neni 2) dhe pothuajse në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Në anën tjetër, universaliteti i të drejtave të njeriut çon në zbatimin global të të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut janë të përbashkëta për të gjithë njerëzit në të gjitha kontinentet, pavarësisht nga dallimet kulturore dhe ekonomike. Parimisht, të drejtat e njeriut shpesh përshkruhen si të drejta qenësore të secilit individ.

Ndërsa, qenia është e patjetërsueshme. Prandaj të drejtat e njeriut nuk mund të tjetërsohen. Sidoqoftë, në praktikë ndodh kur të drejtat mund të tjetërsohen në rrethana të caktuara. Për shembull një person mund të heq dorë nga e drejta e pronës, në favor të dikujt tjetër. Ose një personi mund t'i kufizohet përkohësisht liria e lëvizjes, për shkak të sigurisë së përgjithshme.

Të ndërvarura dhe të pandashme - Ekziston lidhja e ngushtë e të drejtave të ndryshme, përbrenda sistemit të të drejtave të njeriut. Të drejtat e ndryshme janë të varura nga njëra-tjetra dhe plotësojnë njëra-tjetrën, në kuptimin që funksioni i një të drejte ndikon në funksionin e një të drejte tjetër. Për shembull, e drejta për siguri mundëson lirinë e lëvizjes së njeriut. Liria e lëvizjes mundëson zhvillimin ekonomik dhe barazinë. E kështu me radhë.

Të ndërlidhura me përgjegjësitë - Kjo karakteristikë më së miri shprehet përmes pasqyrimin. Një pasqyrim i tillë mund të jetë ndërpersonal dhe brendapersonal. Të drejtat nuk mund të qëndrojnë të ndara nga përgjegjësitë. Sepse një e drejtë e një personi nuk mund të realizohet nëse bota përreth nuk e merr përgjegjësinë që këtë të drejtë ta respektojë. Për shembull, nuk mund të realizohet e drejta e njërit në liri të lëvizjes, nëse të tjerët nuk përmbahen nga veprimet që e kufizojnë këtë liri. Ose, nuk mund të realizohet e drejta e qytetarëve në edukim nëse autoritetet shtetërore nuk sigurojnë kushte për edukim, që nënkupton hapjen e shkollave, organizimin e procesit mësimor, etj. Të dyja këto raste janë shembuj të pasqyrimin ndërpersonal të të drejtave dhe përgjegjësi. Në rastin e parë u ndërlidh e drejta e njërit qytetar me përgjegjësitë e qytetarëve të tjerë, ndërsa në rastin tjetër u ndërlidh e drejta e një qytetari me përgjegjësinë e autoriteteve shtetërore. Në rastin e parë përgjegjësia kishte të bënte me mosveprimin apo përmbajtjen nga veprimi që cenon një të drejtë të tjetrit, ndërsa në rastin e dytë përgjegjësia kishte të bënte me veprimin apo obligimin për të vepruar.

Është shumë me rëndësi të thuhet që secili person që është titullar i të drejtave të njeriut, në të njëjtën kohë ka edhe përgjegjësinë që të respektojë të drejtat e

personave tjerë. Tash flasim për efektin brendapersonal të pasqyrimin. Secila e drejtë e individit përcillet me përgjegjësinë që të respektojë të drejtën e njëjtë të individëve tjerë. E drejta ime në shprehje të lirë të mendimit, në të njëjtën kohë është edhe përgjegjësi e imja për të respektuar shprehjen e lirë të mendimit të të tjerëve. Jo më kot thuhet se e drejta e njërit, përfundon aty ku fillon e drejta e tjetrit. Një përgjegjësi e tillë del nga parimi i barazisë në mes të gjithë njerëzve.

1.2 Zhvillimi evolutiv i të drejtave të njeriut

Të drejtat e njeriut ashtu si i njohim sot nuk kanë ekzistuar gjithmonë. Ato kanë lindur dhe janë zhvilluar duke ndjekur zhvillimin e shoqërisë, pra duke ndjekur kontekstin evolutiv të njerëzimit. Si shembull, të drejtat e tilla si të drejtat e grave, të drejtat e popujve indigjenë, apo të popujve pakicë, lindën si të tilla vetëm në një periudhë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. E drejta në zhvillim të qëndrueshëm, e drejta në shfrytëzimin e burimeve natyrore, u proklamuan vetëm dekadave të fundit, kur njerëzimi u përball me sfida të reja të zhvillimit.

Sot flitet për gjeneratat e të drejtave të njeriut. I pari që ofroi sistemimin e të drejtave nëpër gjenerata, ishte juristi çek Karel Vasak në vitin 1979. Sipas tij, janë tri gjenerata të të drejtave, ndërkaq sot ka autorë që flasin edhe për gjeneratën e katërt:

- ❑ Të drejtat qytetare dhe politike – të drejtat e orientuara kah liria;
- ❑ Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore – të drejtat e orientuara kah barazia;
- ❑ Të drejtat në zhvillim të qëndrueshëm – të drejtat e orientuara kah solidariteti;
- ❑ Të drejtat në qeverisje të mirë.

Ndër këto gjenerata të të drejtave të njeriut, dy të parat tashmë janë të sanksionuara me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. E treta është më e diskutueshme edhe pse tashmë ka një mori zhvillimesh për t'i dhënë njohje ligjore dhe politike. Ndërsa gjenerata e katërt është akoma në formësim.

1.3 Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut i quajmë të gjitha dokumentet në fushën e të drejtave të njeriut që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare apo organizatat ndërkombëtare. Sipas një kategorizimi, ato mund të klasifikohen në deklarata, që miratohen nga organizata të tilla si Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, të cilat nuk janë ligjërisht detyruese ndonëse politikisht mund të jenë të tilla; dhe marrëveshje apo konventa, të cilat janë instrumente legalisht të detyrueshme të nxjerra sipas ligjit ndërkombëtar.

Lloji i dokumentit	Lloji i përgjegjësisë		
	juridike	morale	politike
Konventat	✓	✓	✓
Deklaratat		✓	✓

Më tutje, instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mund të ndahen në instrumente globale, palë e të cilave mund të jetë çdo shtet në botë; dhe instrumente rajonale, që janë të kufizuara në shtetet e një rajoni të posaçëm të botës.

Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut – është instrumenti më i rëndësishëm i të drejtave të njeriut. Ajo u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948. Ajo përbëhet nga 30 nene të cilat paraqesin pikëpamjet e Asamblesë së Përgjithshme lidhur me të drejtat e njeriut që i garantohen të gjithë njerëzve. Megjithëse legalisht e padetyrueshme, kjo deklaratë i nxiti shtetet anëtare të promovojnë një numër të të drejtave civile, ekonomike dhe sociale, duke pohuar se këto të drejta janë pjesë e “krijimit të lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë”. Deklarata ishte përpjekja e parë ligjore për të kufizuar lirinë e sjelljes së shteteve dhe përmes tyre për të shtruar detyrime mbi qytetarët duke ndjekur modelin e dualizmit midis të drejtave dhe përgjegjësisë.

Instrumentet tjera të të drejtave të njeriut kanë lindur si nevojë e rregullimit të grupeve dhe aspekteve të veçanta të të drejtave të njeriut dhe, të gjitha si rregull thirren në parimet e të drejtave të njeriut që i vendosi Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut.

Një listë të instrumenteve ndërkombëtare sipas fushave të të drejtave të njeriut që adresojnë mund ta gjeni në faqen Zyres së Komisionerit të Lartë të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara

<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/UniversalHumanRightsInstruments.aspx> 

2. Të drejtat e fëmijëve

2.1 Specifikat e fëmijëve

Ekzistojnë disa kategori të njerëzve që kanë veçori që i dallojnë nga të gjithë njerëzit tjerë. Kategori të tilla janë fëmijët, personat me nevoja të veçanta, popujt indigjenë, refugjatët, etj. Për këto kategori të njerëzve edhe të drejtat e njeriut marrin kuptim të veçantë, sepse duhet t'u adaptohen rrethanave dhe karakteristikave të tyre. Prandaj ka lindur nevoja që të drejtat e këtyre kategorive të njerëzve të rregullohen në mënyrë të veçantë me instrumente ndërkombëtare dhe me legjislacion vendor. Fëmijët dhe të rriturit janë të njëjtë në aspektin që të dy grupet janë qenie njerëzore që posedojnë të gjitha karakteristikat dhe mundësitë që janë të qenësishme për njeriun. Sidoqoftë, ata janë të ndryshëm në nivelin e zhvillimit të këtyre mundësive dhe karakteristikave. Fëmijët ende nuk i kanë zhvilluar aftësitë e veta plotësisht. Atyre u nevojitet një udhëheqje nga të rriturit.

Kur flasim për fëmijën, duhet të kemi parasysh në radhë të parë zhvillimin e fëmijës. Këtij zhvillimi duhet përshtatur masat që ndërmerr shoqëria.

Zhvillimi i fëmijës i ka tri sfera kryesore:

- Zhvillimi fizik – ndryshimet në madhësinë e trupit, shfaqja dhe funksionimi i sistemeve të ndryshme trupore, zhvillimi i trurit, kapacitetet e perceptimit e ato motorike dhe shëndeti fizik;
- Zhvillimi kognitiv – zhvillimi i një llojllojshmërie të gjerë të proceseve mendore dhe aftësive intelektuale, duke përfshirë vëmendjen, kujtesën, dijen akademike dhe të përditshme, zgjidhjen e problemeve, imagjinatën, kreativitetin dhe mundësinë për të paraqitur botën përmes gjuhës;

- Zhvillimi emocional dhe social – zhvillimi i komunikimit emocional, të kuptuarit e vetvetes, aftësia për të menaxhuar ndjenjat, njohuritë për njerëzit tjerë, shkathtësitë ndërpersonale, miqësitë, marrëdhëniet e afërta, si dhe arsyetimi moral e mirësjellja.

Përkufizimi i këtillë i zhvillimit të fëmijës dhe këto sfera të zhvillimit të fëmijës na vetëdijesojnë për specifikat e fëmijëve në raport me të rriturit. Fëmijët janë qenie njerëzore që janë në fazën e zhvillimit fizik dhe të pjekurisë emocionale. Si të tillë, ata kanë nevojë të veçanta që nuk i kanë njerëzit tjerë. Sepse duke qenë qenie njerëzore jo krejtësisht të pjekura fizikisht dhe emocionalisht, fëmijët nuk mund të gëzojnë të gjitha të drejtat që u takojnë, pa pasur ndihmën e të rriturve dhe kujdesin e shtuar të shtetit. Këto fakte u japin të drejtave të fëmijës një dimension tjetër dhe një specifikë në raport me të drejtat e njeriut.

2.2 Nevoja për të trajtuar veçanërisht të drejtat e fëmijëve

Karakteristikat specifike të fëmijëve në raport me të rriturit kanë shtruar nevojën që të drejtat e fëmijës të trajtohen në mënyrë të veçantë duke u rregulluar përmes akteve të veçanta dhe duke përfshirë mekanizma të veçantë në mbrojtjen e këtyre të drejtave. Duke qenë grup në nevojë dhe të paafët plotësisht që në mënyrë të pavarur të realizojnë të drejtat e tyre, fëmijët varen nga kujdesi i të rriturve dhe sidomos nga kujdesi institucional. Përvojat e deritashme, përfshirë edhe këto të kohës së fundit, tregojnë se janë pikërisht të drejtat e fëmijëve që cenohen më së shumti në situata të luftës, por edhe në situata të paqes, në vendet ku institucionet nuk kanë krijuar politika dhe mekanizma të qëndrueshëm të kujdesit ndaj qytetarëve. Milionësh janë numrat e fëmijëve që dekadën e fundit kanë vdekur në konflikte të armatosura, atyre që kanë dëmtime serioze mentale nga luftërat, atyre që janë të përfshirë në operacionet luftarake. Më tutje, po aq fëmijë, po ashtu vuajnë nga uria, mungesa e kujdesit shëndetësor, shfrytëzimi

seksual, puna e rëndë dhe shumëçka tjetër. Të gjitha këto e arsyetojnë angazhimin ndërkombëtar dhe të shteteve veç e veç, për të rregulluar të drejtat e fëmijëve dhe për të krijuar mekanizma të qëndrueshëm për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave.

2.3 Vështrim historik i trajtimit të të drejtave të fëmijëve

Shekulli XX që nga dekadat e para, karakterizohet me nisma e angazhime të rëndësishme në fushën e të drejtave të fëmijës. Bartës të këtyre nismave janë njerëz të vullnetit të mirë, të mobilizuar individualisht dhe në organizata të ndryshme. Këto angazhime kanë rezultuar me një varg dokumentesh që fuqizuan të drejtat e fëmijëve në botë.

Disa nga këto janë:

- Deklarata e të Drejtave të Fëmijës, e njohur edhe si Deklarata e Gjenevës e të Drejtave të Fëmijës, është një dokument ndërkombëtar që promovon të drejtat e fëmijës, i shkruar nga Eglantyne Jebb dhe i miratuar nga Lidhja e Kombeve më 1924.
- Në frymën e parimeve që kishte përcaktuar Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1959 shpalli Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës.
- Më 1979, gjatë vitit ndërkombëtar të fëmijës, u bë një propozim për të zgjeruar këtë deklaratë dhe për ta bërë të obligueshme nën ligjin ndërkombëtar. Në rrjedhën e këtyre përpjekjeve u prezantua drafti i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës i shkruar nga qeveria e Polonisë.
- Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijës, u miratua nga KB më 20 nëntor 1989 dhe hyri në fuqi më 2 shtator 1990.

2.4 Të drejtat e fëmijës sipas vështrimit të Konventës për drejtat e fëmijës

Konventa për të Drejtat e Fëmijës ka kuptimin e njëjtë për njerëzit në të gjitha anët e botës. Ndërsa vendos standardet e zakonshme, Konventa merr parasysh realitetet e ndryshme kulturore, sociale, ekonomike dhe politike të shteteve individuale, ashtu që çdo shtet duhet të gjejë mënyrat e duhura për të zbatuar të drejtat që i përkasin të gjithëve.

Janë katër parime të përgjithshme të ruajtura në Konventë. Ato ndihmojnë në interpretimin e Konventës në tërësi, duke udhëzuar kështu programet nacionale të zbatimit. Katër parimet janë formuluar në mënyrë të posaçme në nenet 2, 3, 6 dhe 12.

Mosdiskriminimi (neni 2) - Shtetet palë duhet të sigurojnë që të gjithë fëmijët brenda juridiksionit të tyre t'i gëzojnë të gjitha të drejtat. Asnjë fëmijë nuk duhet të provojë diskriminimin pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, religjioni, mendimi politik apo tjetër, nga origjina kombëtare, etnike, apo sociale, nga statusi ekonomik, apo sipas lindjes, si i vet fëmijës, ashtu edhe i prindit, apo i kujdestarit ligjor të tij.

Interesi më i mirë i fëmijës (neni 3) - Kur autoritetet e shtetit marrin vendime që ndikojnë në fëmijët, interesit më të mirë të fëmijës duhet t'i jepet vëmendje parësore. Ky parim lidhet me vendimet e gjykatave, autoriteteve administrative, trupave legjislativë dhe institucioneve publike e private të mirëqenies sociale. Ky është, natyrisht, mesazhi themelor i Konventës, zbatimi i të cilit është sfida më e madhe.


E drejta në jetë, mbijetesë dhe zhvillim (neni 6) - Ky parim përfshin formulime lidhur me të drejtën e mbijetesës dhe zhvillimit, që duhet të sigurohet "deri në masën më të madhe të mundshme". Termi "zhvillim" duhet të

interpretohet në kuptimin e gjerë, duke i dhënë dimensionin e cilësisë: jo vetëm shëndeti fizik është menduar, por edhe zhvillimi mental, emocional, kognitiv (njohës), social dhe kulturor.

Pikëpamjet e fëmijës (neni 12) - Fëmijët duhet të jenë të lirë për të shfaqur mendime lidhur me çdo çështje që ndikon në ta dhe këtyre mendimeve duhet t'u jepet peshë e duhur në përputhshmëri me moshën dhe pjekurinë e fëmijëve. Ideja themelore është që fëmijët kanë të drejtë të dëgjohen dhe që pikëpamjet e tyre të merren seriozisht, duke përfshirë edhe çdo procedurë gjyqësore apo administrative që ka ndikim në ta.

2.5 Forma e Konventës

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës fillon me hyrjen apo preambulën. Pjesa normative e Konventës i përmban 54 nene, që sistemohen në tri pjesë. Pjesa e parë, ku janë 41 nenet e para, përcakton obligimet e shtetit në sigurimin, mbrojtjen dhe fuqizimin e të drejtave të fëmijëve. Pjesa e dytë, që përfshin nenet 42 deri 45, merret me përcaktimin e mekanizmave për sigurimin e zbatimit të Konventës. Në këtë pjesë përcaktohen detyrat e shteteve palë për të raportuar për përparimet në zbatimin e konventës, pastaj kompetencat e Komitetit mbi të Drejtat e Fëmijës, si dhe pjesëmarrja e agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara në shqyrtimin e zbatimit të Konventës dhe dhënien e opinioneve për çështje konkrete që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës. Ndërsa pjesa e tretë, që fillon me nenin 46 dhe mbaron me nenin 54 përcakton çështjet procedurale që kanë të bëjnë me konventën si: hyrja në fuqi, aderimi i shteteve të reja në Konventë, propozimi i amandamenteve nga ana e shteteve, paraqitja e rezervave të shteteve gjatë ratifikimit apo aderimit, gjuhët zyrtare të Konventës, etj.



2.6 Përmbajtja e Konventës

Sa i përket materies së Konventës, mund të dallohen disa pjesë të cilat identifikohen përmes grumbujve specifikë të çështjeve që trajtojnë. Kështu të dallueshme janë pesë pjesë:

1. Të drejtat dhe liritë qytetare

- (a) Emri dhe shtetësia **(neni 7)**;
- (b) Ruajtja e identitetit **(neni 8)**;
- (c) Liria e shprehjes **(neni 13)**;
- (ç) Qasja në informacion të duhur **(neni 17)**;
- (d) Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit **(neni 14)**;

- (dh) Liria e bashkimit dhe mbledhjeve paqësore **(neni 15)**;
- (e) Mbrojtja e intimitetit **(neni 16)**;
- (ë) E drejta për të mos iu nënshtruar torturës, e as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese **(neni 37)**.

2. Mjedisi familjar dhe kujdesi alternativ

- (a) Drejtimi dhe udhëheqja e prindërve **(neni 5)**;
- (b) Përgjegjësitë e prindërve **(neni 18)**;
- (c) Ndarja nga prindërit **(neni 9)**;
- (ç) Ribashkimi i familjes **(neni 10)**;
- (d) Sigurimi i mjeteve të jetesës për fëmijë **(neni 27)**;
- (dh) Fëmijët që u është mohuar mjedisi familjar **(neni 20)**;
- (e) Adoptimi **(neni 21)**;
- (ë) Zhvendosjet e paligjshme dhe mosrikthimet **(neni 11)**;
- (f) Shpërdorimi dhe mospërfillja (neni 19), duke përfshirë shërimin fizik dhe psikologjik dhe ri-integrimin shoqëror **(neni 39)**;
- (g) Rishikimi periodik i vendosjes **(neni 25)**.

3. Shëndeti themelor dhe mirëqenia


- (a) Mbijetesa dhe zhvillimi **(neni 6)**;
- (b) Fëmijët me paaftësi **(neni 23)**;
- (c) Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore **(neni 24)**;
- (ç) Sigurimi social dhe shërbimet e pajisjet për kujdes ndaj fëmijëve **(neni 26 dhe 18)**;
- (d) Standardi i jetesës **(neni 27)**.

4. Edukimi, koha e lirë dhe aktivitetet kulturore

- (a) Arsimiti, duke përfshirë trajnimet dhe udhëzimet profesionale **(neni 28)**;
- (b) Synimi i arsimimit **(neni 29)**;
- (c) Koha e lirë, argëtimi dhe aktivitetet kulturore **(neni 31)**.

5. Masat e posaçme të mbrojtjes

- (a) Fëmijët në situata të jashtëzakonshme (neni 22, 38 dhe 39);
- (b) Fëmijët në konflikt me ligjin (neni 37 dhe 40);
- (c) Fëmijët në situata të shfrytëzimit (nenet 32, 33, 34, 35 dhe 36);
- (ç) Fëmijët që u takojnë grupeve minoritare apo indigjene (neni 30).



2.7 Konventa si burim i politikave globale

Padyshim se Konventa për të Drejtat e Fëmijëve është bazamenti i secilit veprim në fushën e të drejtave të fëmijëve. Parimet e saj janë të përqafuara në politika ndërkombëtare që prekin jetën e fëmijëve, por edhe në politikat vendore e lokale.

Komuniteti ndërkombëtar në vitin 2000 lansoi Objektivat Zhvillimore të Mileniumit, një nismë e liderëve botërorë e përbërë prej 8 objektivave që nisin me zhdukjen e varfërisë dhe urisë, e përfundojnë me partneritetin ndërkombëtar për zhvillim, të gjitha me qëllim të përmirësimit të jetesës së më të varfërve. Me përfundimin e periudhës së Objektivave Zhvillimore të Mileniumit më 2015, viti 2016 ishte viti kur liderët botërorë në Kombet e Bashkuara zyrtarisht lansuan Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kjo agjendë promovon 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm për ta transformuar botën deri më 2030¹. Për t'u arritur këto objektiva secili duhet të bëjë pjesën e vet të punës: qeveritë, sektori privat, shoqëria civile dhe të gjithë qytetarët. Arritja e këtyre objektivave është posaçërisht e rëndësishme në kontekst të fëmijëve, sepse të gjitha ato prekin më së shumti fëmijët.

 <p>1 NO POVERTY</p>	<p>Eliminimi i varfërisë në të gjitha format, kudo</p>	 <p>2 ZERO HUNGER</p>	<p>Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme</p>
 <p>3 GOOD HEALTH AND WELL-BEING</p>	<p>Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe</p>	 <p>4 QUALITY EDUCATION</p>	<p>Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë</p>
 <p>5 GENDER EQUALITY</p>	<p>Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave</p>	 <p>6 CLEAN WATER AND SANITATION</p>	<p>Sigurimi i disponueshmërisë dhe administrimit të qëndrueshëm të ujësjellës-kanalizimeve për të gjithë</p>

¹ <http://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>



Sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë



Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit



Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirës, të parrezikshme, rezistuese dhe të qëndrueshme



Marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektin e tij (në bazë të marrëveshjeve të arritura në forumin e Konventës kornizë të OKB-së për Ndryshimin e Klimës, UNFCCC)



Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë, ndalimi e kthimi pas i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit



Fuqizimi i mënyrave të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm



Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë



Zvogëlimi i pabarazisë brendapërbrenda vendeve dhe mes tyre



Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit



Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm



Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet



3. Mjedisi mik për fëmijën

Rëndësia e mjedisit që e rrethon fëmijën është shumë e madhe për zhvillimin psiko-fizik dhe social të fëmijës. Ky mjedis përfshin kushtet fizike të jetesës, shërbimet në dispozicion dhe marrëdhëniet sociale në mjedisin që jeton. Shoqëria, nisur nga prindërit e kujdestarët, e deri te institucionet e nivelit lokal e qendror duhet të kujdeset që mjedisi në të cilin jeton fëmija të ofrojë mundësi zhvillimi në aspektin psiko-fizik, kognitiv e social. Familja, lagjia, shkolla, qyteti janë pjesë e mjedisit që duhet të jetë miqësor ndaj fëmijës.

Prej lindjes dhe përgjatë rritjes fëmijëve u nevojitet edukim i sigurt në mjedis miqësor dhe stimulues. Sa më shumë dashuri e ndërveprim që fëmijët pranojnë në një mjedis të sigurt e miqësor, aq më shumë ata do të ndërveprojnë në aspektin social, të mësojnë dhe përfitojnë shkathtësi të reja dhe në fund të fundit të zhvillohen në plotni përgjatë jetës. Kur fëmijët përkrahen aktivisht nga kujdestarët për të zhvilluar potencialin e tyre gjatë fëmijërisë së hershme, ata përgatiten mirë për shkollë dhe kështu përfitojnë më shumë nga arsimimi. Ata po ashtu fitojnë më shumë vetëbesim, janë më të mirë në ndërveprim social dhe kontribuojnë më pozitivisht në të gjitha aspektet e jetës familjare dhe sociale. Qofshim prindër, motra, vëllezër, gjyshër, fqinj apo ofruer të shërbimeve, të gjithë ne jemi kujdestarë përgjegjës për jetën më të mirë në fëmijëri për fëmijët. Këtë ua kemi borxh atyre sepse është një e drejtë e tyre e qenësishme. Ia kemi borxh edhe vetvetes për t'i parë fëmijët të rriten në një mjedis të sigurt e miqësor dhe të përparojnë në jetë.

“Njerëzimi ua ka borxh fëmijëve më të mirën që mund t’ua japë”.

(Eglantine Jebb)

3.1 Ndikimi i mjedisit social dhe marrëdhënieve sociale në zhvillimin e fëmijës

Ka mjaft prova që demonstrojnë se mjedisi social i individit ndikon në zhvillimin e tij. Për shembull ekziston hipoteza se fëmijët mund të imitojnë

atë që shohin në mjedisin e tyre, kështu që ata që rriten në një mjedis që karakterizohet me nivel të lartë të edukimit dhe kujdesit ndaj fëmijës, me qasje në një varg shërbimesh themelore e ndërtesash rekreacionale, si dhe me kohezion social, provojnë zhvillim më të mirë se sa ata që rriten në mjedis që karakterizohet me mungesë të burimeve dhe me antagonizma sociale.

Zhvillimi kognitiv dhe arritjet arsimore - Mjedisi social i fëmijës ndikon në zhvillimin kognitiv dhe arritjet arsimore. Fëmijët që përfshihen në marrëdhënie sociale të mira, kanë performancë më të mirë akademike se sa të tjerët. Fëmijët që kanë siguri në aspekt të banimit, kanë më pak gjasa që të mungojnë në shkollë dhe kanë rezultate më të mira. Fëmijët që jetojnë në lagje më cilësi të ulëta banimi (p.sh. me gjendje të jo të mirë socio-ekonomike) kanë më shumë gjasa që të braktisin shkollën para përfundimit. Fëmijët që kanë mundësi të vijnë edukimin parafillor kanë rezultate më të mira në vazhdim dhe ka më pak gjasa që ata ta përsërisin vitin.

Mirëqenia emocionale dhe psikologjike - Ndjenja e përkatësisë të cilën e provojnë individët kur kanë marrëdhënie të mira sociale ka ndikim pozitiv në aspektin emocional dhe psikologjik. Zakonisht këta fëmijë kanë vetëbesim më të madh dhe kanë më pak gjasa që të përjetojnë problem me shëndetin mental, përfshirë depresionin dhe ankthin. Kjo është megjithatë vetëm tendencë, pasi nuk do të thotë që fëmijët që janë më introvertë, të kenë doemos probleme të këtitilla – ata mund të kenë shëndet të plotë mental dhe qetësi të plotë.

Mjedisi social ndikon në shëndetin e fëmijës edhe përmes ndikimit në sjelljen e prindërve. Një studim në Australi ka arritur të përfundimet se prindërit që jetojnë në komunitete ku shërbimet ishin më të arritshme, ishin më pak të prirur të përdorin metoda të ashpra prindërore (që kanë ndikim negativ psikologjik te fëmijët), se sa prindërit që jetojnë në komunitete ku ka mungesë të burimeve.

Motivimi - Individët që jetojnë në mjedise sociale të karakterizuara me marrëdhënie pozitive sociale janë më të motivuar se sa ata që nuk jetojnë në mjedise të këtitilla. Për shembull, mbështetja e moshatarëve konsiderohet të jetë shtytje e motivimit të fëmijës për të ndjekur qëllimet sociale, derisa mbështetja e mësime dhënëve e rrit motivimin e nxënësve si për të ndjekur qëllimet sociale ashtu edhe ato akademike. Mbështetja prindërore po ashtu ndikon në fëmijët në aspekt të interesimit të tyre për shkollë dhe ndjekje të qëllimeve të tyre.

Shëndeti fizik - Mjedisi pozitiv social promovon shëndet fizik të përmirësuar, duke përfshirë: rrezik të ulur të çrregullimit të ushqimit, gjasa të rritura për të qenë të vaksinuar, rrezik të ulët të shtatzënive të të miturave, aftësi të shtuara për sport, etj.

3.2 Kujdesi dhe edukimi i bazuar në të drejtat e fëmijës

Është jashtëzakonisht e rëndësishme për çdo shoqëri që t'i kushtojë kujdes të duhur kujdesit dhe edukimit të fëmijës. Edukimi përgjithësisht është vegla më e mirë për të pajisur fëmijët me njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera. Këto kompetenca mundësojnë që gjenerata e ardhshme e qytetarëve të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore dhe të manifestojë sjellje të qytetarisë demokratike. Edukimi i bazuar në të drejtat e fëmijës ndërkaq, mundëson krijimin e një mjedisi të dashur për fëmijët, një mjedis premtues për të ardhmen. Në një mjedis të tillë, të rriturit janë të vetëdijshëm për nevojën e ndihmës ndaj fëmijëve dhe janë të mobilizuar që të veprojnë në lehtësimin e realizimit të të drejtave të fëmijës. Edhe fëmijët do të krijojnë një qëndrim tjetër, sepse do të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e veta, për mënyrën më të lehtë për të realizuar ato, për adresat e atyre që mund të jenë në ndihmë të tyre, etj. Por edukimi i bazuar në të drejtat e fëmijës, nuk do të thotë që fëmijët t'i njohim vetëm me të drejtat që kanë. Përmes një edukimi të tillë duhet të arrijmë t'i bëjmë fëmijët të ndërgjegjshëm edhe për

sjelljet e veta në raport me të rriturit dhe me moshatarët e tyre. Duhet t'i pajisim me vlera të humanitetit dhe përgjegjësisë siç janë: komunikimi i mirë, empatia, bashkëpunimi, gjykimi i drejtë, toleranca, solidariteti, etj.

Edukimi i fëmijës fillon me lindjen e fëmijës dhe realizohet në vazhdimësi. Kjo vazhdimësi në asnjë mënyrë nuk është e njëtrajtshme, sepse është e varur shumë nga moshën e fëmijës dhe nga mjedisi që e rrethon fëmijën. Të dy këta faktorë – moshën dhe mjedisin, ndërveprojnë dhe së bashku përbëjnë shtresën bazë të gjithë procesit. Këta mund të quhen edhe faktorë të drejtpërdrejtë, derisa ka edhe një varg faktorësh që ndikojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, shpesh duke zbankuar peshën e vet përmes mjedisit. Të tillë faktorë mund të jenë situata ekonomike e sociale në një shoqëri, infrastruktura ligjore dhe zbatimi i ligjit, vullneti politik, vetëdija qytetare, etj. Në një mënyrë, këta faktorë mund të quhen edhe parakushte, sepse përcaktojnë cilësinë e angazhimit të njerëzve që ndërveprojnë drejtpërdrejt me fëmijën, që përgjatë moshës në lëvizje të fëmijës, të ofrojnë edukimin në përgjithësi dhe përgatitjen e fëmijës si qytetar i ndërgjegjshëm, në veçanti.

Këshilla për prindër:

- Dashuria prindërore është qenësore dhe parakusht për zhvillimin e të gjitha shkathtësive të fëmijës.
- Harmonia, siguria dhe përkrahja në familje ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e fëmijës.
- Vetëbesimi i fëmijës është i rëndësishëm për zhvillimin e potencialit të tij/saj.
- Si djemtë, ashtu edhe vajzat kanë nevojë për përkujdesje të njëjtë gjatë zhvillimit të tyre.
- Komunikimi i mirë me fëmijën që nga fillimi krijon marrëdhënie të shëndosha dhe ndikon në zhvillimin e fëmijës.

3.3 Përfshirja e palëve të ndryshme në edukimin e fëmijës

Pas lindjes, fëmijës i kushtohet kujdesi nga prindërit dhe rrethi familjar. Që me frymën e parë, fëmijët fillojnë mësimin që përcakton qëndrimin e tyre ndaj të tjerëve. Mënyra se si fëmijët trajtohen nga familjet e tyre dhe natyra e përkujdesjes që ata përjetojnë, do t'i udhëzojë ata se si vlerësohen, lidhur me vlerat e tyre njerëzore që kanë dhe çfarë mund të presin nga bota. Kjo eksperiencë ka një ndikim të thellë në mënyrën se si fëmija e sheh botën dhe ata që jetojnë në të. Dashuria dhe kujdesi prindëror paraqesin shenjat e para që fëmija merr nga rrethi, lidhjet e para të natyrës emocionale me njerëzit që e rrethojnë. Fëmijët mësojnë dashurinë dhe kujdesin duke e përjetuar atë. Këto duhet t'i ofrohen në atë mënyrë që të fëmija të nxisin ndjenjën e të çmuarit të vlerave të veta. Fëmijët që nuk çmojnë vlerat e veta njerëzore, ka pak gjasa që t'i çmojnë vlerat e të tjerëve, as që mund të shndërrohen në qytetarë të brengosur, e aq më pak aktivë për të drejtat e njeriut. Prandaj përkujdesja mund të quhet faza e parë e edukimit për të drejtat e fëmijës.



Edukimi i fëmijës në fazën e hershme të fëmijërisë vazhdon në mjedisin familjar, por shpesh kombinohet edhe me qëndrimin në institucionet parashkollore të tipit të çerdheve. Duke u kujdesur për shëndetin e tyre, duke i ushqyer rregullisht, duke ua plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre, duke u kushtuar rëndësi fjalëve të tyre, duke u ofruar lodra e argëtim, ne i respektojmë të drejtat e fëmijës. Në të njëjtën kohë i vetëdijesojmë fëmijët se këto të drejta janë pjesë përbërëse e qenies së tyre. Duke i këshilluar ata, duke i qortuar për ndonjë veprim të papëlqyer, duke u dhënë shembuj pozitivë përmes sjelljes sonë, ne arrijmë t'i ndërjegjësojmë për normat e sjelljes. Zhvillimi i respektit për të tjerët, vlerësimi i ngjashmërive njerëzore dhe nderimi i dallimeve njerëzore duhet që në mënyrë të vetëdijshme të kultivohet prej fazave të para të socializimit dhe të vazhdojë në fazat tjera. Kuptohet, të gjitha këto bëhen me kujdes të shtuar, duke marrë parasysh moshën shumë të njomë të fëmijëve. Shumë e rëndësishme është atmosfera përreth fëmijës. Marrëdhëniet familjare dhe përgjithësisht marrëdhëniet ndërnjerëzore në rrethinën e fëmijës duhet të jenë të shëndosha që t'i japin fëmijës shembuj pozitivë. Tek disa fëmijë që gjatë ditës shkojnë në çerdhe, duhet pasur kujdes që ndryshimi i mjedisit familjar me atë të çerdhes të mos ndikojë negativisht, të mos krijojë stres, apo komplikime. Përkundrazi, ky ndryshim duhet të prodhojë një freski për ata. Këtu hapet një kapitull në procesin e edukimit të bazuar në të drejtat e fëmijës – bashkëpunimi në mes të prindërve dhe institucioneve edukative. Ky bashkëpunim vazhdon edhe në fazat e mëvonshme, madje bëhet më i nevojshëm dhe fiton në intensitet dhe cilësi.

Në moshën parashkollore fëmija arrin një shkallë të zhvillimit kognitiv dhe kjo i mundëson atij/asaj të analizojë situatat, të bëjë krahasime, të reagojë ndaj ngjarjeve që zhvillohen rreth tij/saj dhe të shfaq më fuqishëm qëndrimet e veta. Të rriturit duhet të kuptojnë këtë dhe të sillen në mënyrë të duhur me fëmijën. Kjo, në radhë të parë nënkupton mbështetjen e fëmijës dhe shmangien e situatave që mund të krijojnë huti te fëmija. Zhvillimi i tillë kognitiv te fëmija tregon se fëmija është përgatitur për një fazë të re, për shkollimin fillor. Mjedis

shkollor është një mjedis që ndryshon nga mjedisi familjar dhe kjo është një gjë interesante për fëmijën. Eksperiencat e reja nga jeta shkollore e plotësojnë fotografinë që fëmija ka për botën dhe e ndihmojnë zhvillimin e mëtutjeshëm të fëmijës. Këtu, edhe një herë duhet t'i kushtohet rëndësi bashkëpunimit të shkollës me prindërit. Prindërit duhet të jenë pjesë e shkollës, duke ndihmuar shkollën me informacione për fëmijët, duke ndihmuar në menaxhimin e përditshëm të situatave e ngjarjeve në shkollë.


Në të njëjtën kohë prindërit kontribuojnë në përshtatjen më të mirë të fëmijës në shkollë. Për fëmijën është shumë me rëndësi të kuptojë se jeta e tij/saj nuk ka pësuar ndonjë shpërbërje, se prindërit janë të pranishëm edhe në jetën e tij/saj shkollore. Për këtë, rol të madh ka edhe shkolla e cila duhet të ofrojë mundësi për përfshirje të prindërve në punët e shkollës.

Për të marrë informata shtesë rreth bashkëpunimit në mes të familjes dhe institucioneve edukative, mund ta konsultoni udhëzuesin që gjendet në këtë vegëz:

<https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/manual%20per%20prinderit%20%281%29.pdf> 

Duhet të marrim parasysh se mjedisi i fëmijës nuk mbaron me familjen dhe shkollën. Fëmija mund të jetë pjesë e një klubi sportiv, një shkolle muzike, kursi të gjuhëve të huaja, teatri amator, etj. Gjitha këto vende shërbejnë për fitimin e shkathtësive të veçanta dhe për përparimin e talenteve personale të fëmijës. Por këto duhet të shfrytëzohen edhe për edukimin e përgjithshëm të fëmijës, të bazuar në të drejtat e fëmijës.

Në fakt, këto veprimtari janë realizim i të drejtave të fëmijës, sepse e drejta në lojë, argëtim dhe pjesëmarrje në aktivitetet kulturore e artistike realizohet



përmes sportit, muzikës, teatrit, etj. Çështja këtu qëndron te vetëdijesimi dhe edukimi i fëmijës. Qëndrimi i trajnerit sportiv, instruktorit të muzikës, udhëheqësit të teatrit, apo mësuesit të gjuhëve të huaja, duhet të reflektojë te fëmija vlera pozitive. Ai qëndrim e tejkalon qëllimin fillestar të pajisjes së fëmijës me shkathtësitë e veçanta. Kjo, në fund të fundit është në përputhje me definicionin bashkëkohor të edukimit.

Nga figura në të majtë lehtë mund të nxjerrim përfundimin se përveç që ekzistojnë “lojtarë” të shumtë mjedisorë në edukimin për të drejtat e fëmijëve, ndërveprimi i këtyre “lojtarëve” është i domosdoshëm. Në mes tyre ka shkëmbim informatash, këshillime të ndërsjella, veprime të përbashkëta dhe forma tjera ndërveprimi që i kontribuojnë krijimit të qytetarit të ri, të ndërgjegjshëm.

3.4 Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijës si pjesë e mjedisit mik për fëmijë

Përtej edukimit, duhen masa të shumta për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Për të siguruar këto masa në fushën e shëndetit, mirëqenies sociale, sigurisë, drejtësisë për fëmijë, kohës së lirë e rekreacionit, etj., në radhë të parë janë përgjegjëse institucionet, si ato të nivelit lokal, ashtu edhe ato të nivelit qendror.

Puna e këtyre institucioneve plotësohet me punën e grupeve joformale dhe formale të shoqërisë civile, si dhe mekanizmeve tjerë të kombinuar që formohen e operojnë në funksion të sigurimit të këtij mjedisi ku të drejtat e fëmijës mbrohen dhe promovohen.

Për të ilustruar se sa shumë institucione, agjensi, organizata e grupe tjera përfshihen në këtë ndërmarrje gjithëpërfshirëse për të drejtat e fëmijës, po e japim grafikun në vijim. Padyshim, këtij grafiku mund t'i shtohen palë tjera.



Disa mekanizma për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës jepen më poshtë krahas një përshkrimi të punës së tyre. Duhet pasur parasysh se disa mekanizma lidhen me institucionet e nivelit qendror (ministrinë e linjës),

por veprimtarinë e zhvillojnë në nivel lokal, prandaj ndonëse janë të lidhur në mënyrë hierarkike me nivelin qendror të qeverisjes, në praktikë janë të lidhur shumë me komunat si nivel lokal i qeverisjes.

Qendra për punë sociale (QPS) – Operon në fushën e mirëqenies sociale. Bën menaxhimin e skemave të asistencës sociale si dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët që kanë nevojë për mbrojtjen, zhvillimin dhe rehabilitim e tyre (fëmijë të braktisur, fëmijë jetim, fëmijë të keqtrajtuar, fëmijë të lënë pas dore, fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë prindërit e të cilëve janë të penguar në kryerjen e të drejtës prindërore, fëmijë të prindërve të shkurorëzuar apo të ndarë). Pjesë tjera të punës së qendrave për punë sociale janë edhe: caktimi i menaxherit të rastit; vlerësimi profesional i nevojave të fëmijës; zhvillimi i këshillimeve me rrethin familjar; këshillimi psikosocial për fëmijën dhe familjen; përkujdesja për ofrimin e shërbimit mjekësor dhe arsimor, etj. Në format e mbrojtjes së fëmijës që janë kompetencë e QPS bëjnë pjesë: kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial, asistencë sociale sipas nevojës, bashkimi familjar, adoptimi.

Prokuroria dhe gjykatat – ushtrojnë detyrat në fushën e drejtësisë. Lidhur me fëmijët këta mekanizma ofrojnë mbrojtje të veçantë për fëmijët. Më konkretisht departamenti për të mitur i prokurorisë themelore bën ndjekjen e veprave penale të kryera nga të miturit (14-18 vjeç), ndërsa departamenti për të mitur i gjykatës themelore bën gjykimin e veprave penale të shkaktuara nga të miturit.

Të dyja këto organe marrin masa të veçanta mbrojtëse ndaj fëmijëve duke u përkujdesur për mirëqenien e të miturve; që çdo masë ose ndëshkim ndaj kryesve të veprave që janë të kësaj grupmoshe të jetë në proporcion me rrethanat e shkelësit dhe veprës dhe që të drejtat e të miturve për privatësi të respektohen në të gjitha fazat për t'iu shmangur çdo dëmtimi nga publiciteti jo i duhur. Po ashtu, marrin masa të veçanta për të mbrojtur dinjitetin dhe të drejtat e të miturve në kontakt me ligjin.

Policia e Kosovës – Punon në ndihmë të fëmijëve delikuentë, viktimave dhe të dyshuar. Merret me parandalim dhe vetëdijësim, mbrojtje, ndihmë emergjente të viktimave, referim të viktimave (në prokurori, qendër për punë sociale, spital, gjykatë, mbrojtësi i viktimave) sigurim të viktimave, etj. Policia, po ashtu bashkëpunon me palë tjera që të parandalohen rastet e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, sikur janë shpërdorimi i fëmijëve përmes trafikimit, punës së rëndë të fëmijëve, dhunës ndaj fëmijëve, etj.

Shërbimi sprovues i Kosovës – Merret me ekzekutimin e dënimeve dhe masave alternative, mbikëqyrjen, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin e të miturve që kanë rënë në konflikt me ligjin. Ka një praktikë të marrëveshjes së bashkëpunimit me komunat për kryerjen e punës pa pagesë, masave të diversitetit (8 lloje të masave) dhe aftësimin profesional të të miturve në konflikt me ligjin.

Mbrojtësi i viktimave – Ofron mbështetje dhe ndihmë viktimave të krimit, për të pasur qasje në organet e drejtësisë. Vepron si përfaqësues i autorizuar i cili ka kompetencë për ta njoftuar palën e dëmtuar për të drejtat e tij/saj dhe për përfaqësimin e interesave të viktimës në procedurën në prokurori dhe gjykatë. E referon viktimën tek ofruesit tjerë të shërbimeve. Vepron në emër të viktimës kur është e nevojshme, dhe e duhur për ta ndaluar shkeljen e të drejtave të viktimës dhe për të kërkuar veprim për garantimin e mbrojtjes së tyre.

Avokati i popullit – Është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit. Fushëveprimi i institucionit të avokatit të popullit lidhet me mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës. Në këndvështrim specifik të fëmijëve, avokati i popullit është i thirrur të hartojë


dhe miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe trajtimin e ankesave nga fëmijët, si dhe krijimin e një ekipi të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe një programi të përhershëm që fëmijët të bëhen të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e tyre.

Mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje - Siguron një reagim të menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës ndaj dhunës në familje. Paraqet koordinim efikas të reagimit institucional për adresimin e rasteve të dhunës dhe kontribuon në krijimin e politikave proaktive kundër dhunës në familje. Punon në përmirësimin/ndërtimin e sistemit të grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të anëtarëve të grupit.

Rrjetet mbrojtëse kundër dhunës në shkollë - Bëjnë sensibilizimin në nivelin komunal dhe shkollor për Protokolin për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkollë, për themelimin e klubeve të bashkëmoshatarëve në nivel shkollor për parandalimin dhe reagim ndaj dhunës në shkollë dhe për njohjen me modulën e incidencës së dhunës në shkollë në kuadër të Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA).

Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (EPRBM) - janë ekipe që themelohen në nivel shkollor dhe në nivel komune, sipas udhëzimit administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës nr. 19/2012. Roli i tyre përmbledhet në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së nxënësve nga arsimi i obliguar, si dhe adresimi i rasteve të mosregjistrimit.

Për punën e këtyre ekipeve mund t'i konsultoni doracakët për këto ekipe që gjenden në vegëzat më poshtë:

https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-shkollore-per-parandalim_1.pdf dhe http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-komunale-per-parandalim_1.pdf 

Këshillat e Veprimit Rinor Lokal - Përfaqësojnë organizatat rinore të komunës ku ata veprojnë para institucioneve gjegjëse lokale. Adresojnë çështjet e të rinjve të komunës para institucioneve komunale dhe para personave të tjerë publikë dhe privatë. Krahas këshillave lokale, funksionon edhe Këshilli Qendror i Veprimit Rinor ku këshillat lokale janë pjesë dhe diskutojnë çështjet që lidhen me të rinjtë.

Këshillat e veprimit rinor lokal u ofrojnë mendime e këshilla organeve dhe institucioneve komunale për veprimet që ato duhet ndërmarrë lidhur me të rinjtë në komunë, paraqesin qëndrime për dokumentet ligjore dhe dokumentet e tjera sa u përket çështjeve për të rinjtë në komunë, merren me avokim, lobim, përfaqësim, koordinim të punës së shoqërisë civile në komunë, por edhe me këshillim, trajnime, hartim apo propozim të politikave, etj.

Asambletë komunale të fëmijëve - janë organizata të fëmijëve, që përbëhen nga fëmijët e shkollave të ndryshme të komunës. Asambletë shërbejnë si vende për të ushtruar demokracinë dhe vende ku fëmijët promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Brenda asambleve, fëmijët po ashtu kanë mundësi të pajisjes me shkathtësi për të shërbyer si avokatë të të drejtave të fëmijëve, si agjentë të ndryshimeve në komunitetin e tyre. Në kuadër të funksionimit të tyre, ato hartojnë plane të veprimit dhe i implementojnë ato në komunitet.

3.5 Komuna mike për fëmijë

Iniciativa “Qytetet mike për fëmijë” është zhvilluar dekada më parë nën udhëheqjen e UNICEF-it dhe është provuar në shumë qytete në botë që nga vitet '90. Ky proces ndihmon të drejtat e fëmijës dhe promovon Konventën për të Drejtat e Fëmijës në nivelin lokal.

Koncepti i krijimit të qyteteve mike për fëmijë mbështetet në identifikimin e hapave për ndërtimin e një sistemi të qeverisjes lokale që zotohet të përmbushë

të drejtat e fëmijëve. Më saktësisht ky është një proces i zbatimit të Konventës së KB për të Drejtat e Fëmijës në nivelin lokal të qeverisjes, në atë nivel ku e ka ndikimin më të madh direkt në jetët e fëmijëve.

Po çfarë do të thotë një qytet mik për fëmijët? Korniza e veprimit për ndërtimin e qyteteve mike për fëmijët² të tillë e cilëson qytetin që i garanton secilit fëmijë e të ri të:

- ndikojë në vendimet për qytetin e vet
- shprehë pikëpamjen për qytetin që dëshiron
- marrë pjesë në jetën e familjes, komunitetit dhe shoqërisë
- marrë shërbimet themelore si kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe strehimi
- pijë ujë të pastër dhe të ketë qasje në higjienën e duhur
- jetë i/e mbrojtur nga shfrytëzimi, dhuna dhe keqtrajtimi
- lëviz lirshëm nëpër rrugët e qytetit, vetëm
- takojë miq e të luaj
- ketë hapësira të gjelbra për bimë dhe kafshë
- jetojë në një mjedis të pastër
- marrë pjesë në ngjarje kulturore dhe shoqërore
- jetë një qytetar i barabartë i qytetit të vet me qasje në secilin shërbim, pa varësisht origjinës etnike, religjionit, të ardhurave, gjinisë apo aftësisë.

Gjakova është komuna e parë në Kosovë që përmes një projekti të financuar nga UNICEF-i e ka hartuar strategjinë dhe planin e veprimit për komunën mike për fëmijë 2017-2021. E gjithë kjo ndërmarrje është bërë duke pasur pikënisje konceptin e qyteteve mike për fëmijë dhe duke u bazuar në kontekstin lokal.

² <https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/cfc-framework-eng.pdf>

3.6 Shkollat mike për fëmijë

Shkollimi është një përvojë e përbashkët për shumicën e fëmijëve anë e mbanë botës, si dhe mjeti më i zakonshëm përmes së cilit shoqëritë i përgatisin të rinjtë për të ardhmen. Prandaj është shumë e rëndësishme që shkollat të ofrojnë mjedis të përshtatshëm për fëmijët, ku ata do të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet si qytetarë të përgjegjshëm. Kjo mund të bëhet vetëm nëse shkollat ofrojnë mundësi të mira mësimi, hapësira fizike të shëndetshme e të sigurta, mbështetje nga mësime dhënësit dhe stafi tjetër, si dhe mbi të gjitha pjesëmarrje aktive të vet nxënësve.

UNICEF-i e ka zhvilluar një kornizë për shkollat mike për fëmijë, të cilat karakterizohen si përfshirëse, të shëndetshme dhe mbrojtëse për të gjithë fëmijët, dhe të përfshira me familjet e komunitetin – dhe vet fëmijët. Brenda kësaj kornize:

- shkolla është një mjedis i rëndësishëm personal dhe social në jetën e nxënësve;
- mësime dhënësit janë faktori më i rëndësishëm në krijimin e klasave efektive dhe gjithëpërfshirëse;
- fëmijët mësojnë natyrshëm, por ky kapacitet për të mësuar mund të dëmtohet, e ndonjëherë edhe të shkatërrohet. Shkolla mike për fëmijë i njeh, i inkurajon dhe i mbështet kapacitetet në rritje të fëmijëve si nxënës duke u ofruar kulturën shkollare, sjelljen e mësime dhënësit dhe përmbajtjen kurrikulare që janë të orientuara në të mësuarit dhe nxënësin;
- aftësia e shkollës për të qenë dhe për ta quajtur veten si mike për fëmijë është drejtpërdrejt e lidhur me mbështetjen, pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin që e merr nga familjet;

- shkolla mike për fëmijë ka për qëllim të zhvillojë një mjedis mësues në të cilin fëmijët janë të motivuar dhe të aftë për të mësuar. Anëtarët e stafit janë miqësorë e të kujdesshëm ndaj fëmijëve dhe i përcjellin të gjitha nevojat e tyre shëndetësore dhe të sigurisë.

Shkollat e këtilla, të bazuara në të drejta dhe miqësore për fëmijët, duhet jo vetëm që t'u ndihmojnë fëmijëve të realizojnë të drejtën e tyre në edukim bazik cilësor. Ato duhet të bëjnë edhe shumë gjëra si: të ndihmojnë fëmijët të mësojnë se si të përballen me sfidat bashkëkohore; të përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve; t'u garantojnë atyre hapësira të sigurta për të mësuar, pa kërcënim nga dhuna dhe shpërdorimi; të rrisin moralin dhe motivimin e mësuesdhënësve; dhe të mobilizojnë përkrahjen e komunitetit për arsim.

Mbi të gjitha, shkolla mike për fëmijë duhet të reflektojë një mjedis të cilësisë së mirë të karakterizuar me disa aspekte thelbësore. Ajo duhet të jetë:

- gjithëpërfshirëse për fëmijët
- efektive në të mësuar
- e shëndetshme dhe mbrojtëse për fëmijët
- e ndjeshme në aspektin gjinor dhe në aspekte tjera sociale
- e përfshirë me fëmijët, familjet dhe komunitetin

Një listë kontrolluese për shkollën e orientuar në të drejta dhe miqësore për fëmijë mund ta gjeni në faqen 78

4. Fuqizimi i fëmijëve përmes pjesëmarrjes

4.1 Koncepti i pjesëmarrjes

Pjesëmarrja e fëmijëve është njëri ndër parimet thelbësore të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, që pohon se fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën që t'i shprehin lirshëm pikëpamjet e tyre, dhe se ekziston një obligim që të dëgjohen pikëpamjet e fëmijëve dhe të lehtësohet procesi i pjesëmarrjes së tyre në të gjitha proceset që kanë ndikim në ta brenda familjes, shkollës, komunitetit lokal, shërbimeve publike, politikave qeveritare dhe procedurave administrative e gjyqësore. E vënë në praktikë, pjesëmarrja është të dëgjuarit e fëmijëve nga ana e të rriturve. Ajo përmban lirinë e tyre për t'i shprehur pikëpamjet dhe marrjen parasysh të këtyre pikëpamjeve në çështjet që ndikojnë në ta. Përfshirja e fëmijëve në dialog dhe shkëmbim social u lejon atyre të mësojnë mënyra konstruktive për të ndikuar në botën përreth.

Pjesëmarrja e fëmijëve duhet të jetë e vërtetë dhe kuptimplote. Ajo duhet të burojë nga vet fëmijët dhe të rinjtë, në mënyrën që atyre u përshtatet dhe në ndjekje të vizioneve, ëndrrave, shpresave dhe brengave të tyre. Mbi të gjitha, pjesëmarrja e vërtetë dhe kuptimplotë e fëmijëve kërkon një ndryshim në të menduarit, qëndrimet dhe sjelljet e të rriturve. Qasja përjashtuese duhet të shndërrohet në qasje përfshirëse ndaj fëmijëve dhe kapaciteteve të tyre.

Promovimi i pjesëmarrjes kuptimplote dhe cilësore të fëmijëve dhe të rinjve është thelbësor për të siguruar si duhet rritjen dhe zhvillimin e tyre. Fëmijët na e kanë provuar se kur janë të përfshirë, ata mund ta bëjnë ndryshimin në botën përreth tyre. Ata kanë ide, përvoja dhe njohuri që pasurojnë kuptimet e të rriturve dhe kontribuojnë në veprimet e të rriturve. Nëse reflektojmë secili nga ne për pak kohë, do të shohim se sa shembuj të këtyllë nga fëmijët në rrethinën tonë gjejmë.

“Asgjë për fëmijët, pa fëmijët. Pra, gjithçka për fëmijët, me fëmijët”.

Anekdote:

Dikur moti kur njerëzit jetonin në kushte me të thjeshta, në një shtëpi të vogël jetonte një nënë me të birin 10 vjeçar. Fqinji i tyre i parë ishte një burrë që të gjithë e konsideronin të mençur dhe me të cilin këshilloheshin për problemet e tyre të ndryshme.

Një natë nëna donte ta ndizte zjarrin, por nuk kishte shkrepës. Kështu, ajo i tha djalit të shkonte te fqinji dhe t'i kërkonte një shkrepës. Kur djali shkoi dhe i kërkoj burrit shkrepësen, ai i tha me keqardhje se nuk i kishte qëlluar ndonjë. Ai më tutje i tha djalit: “unë kam ca gaca thëngjilli me të cilat mund ta ndizni zjarrin, por nuk kam se ku t'i vë që t'i dërgosh deri në shtëpi”. Atëherë djali ia priti: “Mund të vendosni një grumbull hiri në shuplakat e mia dhe mbi të ta vendosni një gacë”. Burri bëri ashtu. Derisa djali iku, ai buzëqeshi lehtë i magjepsur nga zgjidhja që ofroi djali.

“Fëmijët janë padyshim më së shumti të fotografuar dhe më së paku të dëgjuar nga anëtarët e shoqërisë”.

(Roger Hart)


Pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje për çështjet që ndikojnë në ta është një vlerë themelore që përshkruhet në nenin 12 të Konventës. Ajo, megjithatë nuk qëndron e vetmuar brenda këtij neni, por lidhet me përmbajtjen e shumë neneve tjera në Konventë. Kështu ajo është e lidhur me të drejtën në marrje të informacionit që përshkruhet në nenin 13, e që është parakusht për të ushtruar pjesëmarrjen në mënyrë kuptimplotë. Neni 15 ndërkaq tregon se fëmijët kanë të drejtë të kyçen në organizata e shoqata dhe të mblidhen në mënyrë paqësore. Edhe kjo e drejtë është substanciale për të mundësuar pjesëmarrjen aktive qytetare në vendimmarrje. Pjesëmarrja, në anën tjetër është rrugë për të ushtruar një varg të drejtash tjera. Kështu me rastin e birësimit, duhet të merret parasysh edhe pëlqimi i fëmijës, kuptohet në suaza të kapacitetit të fëmijës për të shprehur interesin e vet (neni 21). Njëjtë, opinion i fëmijës duhet të merret edhe me rastin e ndarjes nga prindërit, apo ndërrimit të emrit. E drejta në shëndet mund të realizohet vetëm nëse fëmijët kanë qasje në informacion dhe janë të mbështetur të përdorin njohuritë themelore për shëndetin e vet dhe ushqyeshmërinë (neni 24). Në fushën

e arsimit, pjesëmarrja e fëmijëve merr dimension të posaçëm, pasi e drejta në arsimim do të thotë të ushtrohet qytetaria. Për të ushtruar qytetarinë në gjithë përmbajtjen e vet, fëmijët nuk duhet të konsiderohen si marrës pasivë të njohurive, por si lojtarë aktivë në procesin mësimor (neni 28).

Nuk ekziston një minimum i moshës kur fëmijët mund të fillojnë t'i shfaqin pikëpamjet e tyre lirshëm. Konventa pranon se fëmijët mund të formojnë pikëpamje që nga mosha e hershme dhe i referohet kapacitetit në zhvillim të fëmijëve. Kuptohet, shprehja e pikëpamjeve dhe pjesëmarrja në vendimmarrje rriten në vlerë dhe kuptim teksa fëmijët rriten e zhvillohen, fitojnë pjekuri dhe përvojë, bëhen më të pavarur dhe më të ndërgjegjshëm.

Kapaciteti në zhvillim i fëmijëve paraqet vetëm një anë të ekuacionit. Ana tjetër përfshin kapacitetin në zhvillim të të rriturve dhe gatishmërinë për t'i dëgjuar dhe për të mësuar nga fëmijët, për të kuptuar dhe marrë në konsideratë pikëpamjet e fëmijëve, për të rishikuar pikëpamjet dhe qëndrimet e veta dhe për të parashikuar zgjidhje që adresojnë pikëpamjet e fëmijëve.

Kapaciteti në zhvillim i fëmijëve për të shprehur pikëpamjet e tyre



Kapaciteti dhe gatishmëria e të rriturve për të marrë parasysh pikëpamjet e fëmijëve

Si për të rriturit, ashtu edhe për fëmijët, pjesëmarrja është një proces sfidues i të mësuarit dhe nuk mund të tkurret në një proces të thjeshtë formal. Përmbushja e të drejtës së fëmijëve në pjesëmarrje nënkupton përgatitjen dhe mobilizimin

e të rriturve që jetojnë dhe punojnë me fëmijët, ashtu që të jenë të gatshëm t'u japin fëmijëve mundësitë që lirshëm dhe në mënyrë progresive të marrin pjesë në shoqëri dhe të fitojnë shkathtësi demokratike. Prindërit dhe anëtarët tjerë të familjes janë të përfshirë qartë në këtë grup, ashtu sikurse edhe mësimitdhënësit, por edhe të tjerët në shoqëri që ndërveprojnë me fëmijët.

4.2 Pjesëmarrja e fëmijëve në shkollë

Pjesëmarrja në shkollë nënkupton që fëmijëve t'u lejohet të shprehen për arsimimin e tyre, që ata të dëgohen dhe që të përfshihen sa më shumë që është e mundur në jetën e shkollës. Kjo do të thotë të çmohen pikëpamjet dhe idetë e tyre dhe t'u jepet kontroll në përvojat shkollore. Kur fëmijët kanë të drejtën të shprehen për arsimimin e tyre, ata jo vetëm që ushtrojnë të drejtat e tyre, por po ashtu:

- arrijnë më shumë;
- përmirësojnë vetëbesimin;
- sillen më mirë me bashkëmoshatarët dhe më mësimitdhënësit e tyre;
- kontribuojnë për një mjedis më të mirë shkollor, me disiplinë dhe kulturë më të mirë, ku procesi i të mësuarit është një përgjegjësi e përbashkët.

Shkolla është një mikrokozmos, ku menaxhmenti i shkollës, mësimitdhënësit, nxënësit, prindërit dhe komuniteti i gjerë i shkollës ndërveprojnë vazhdimisht. Prandaj shkolla është një vend ideal për të ushtruar demokracinë. Ndërsa demokracia nuk mund të ushtrohet nëse mungon përfshirja aktive e nxënësve në jetën shkollore, nëse ata nuk marrin pjesë në vendimmarrje lidhur me proceset mësimore dhe mënyrën e udhëheqjes së shkollës.

Fëmijët e kalojnë një pjesë të mirë të orarit ditor në shkollë, prandaj është shumë me rëndësi që kjo kohë të shfrytëzohet që ata të fitojnë njohuri, shkathtësi, vlera e qëndrime të qytetarisë demokratike. Shkolla duhet të ofrojë mundësi që fëmijët të jenë mirë të informuar, të përfshihen, të shfaqin pikëpamjet dhe idetë e tyre, t'i argumentojnë ato dhe të ndikojnë në marrjen e vendimeve në shkollë.

4.3 Organizatat e nxënësve

Organizimi i fëmijëve përmes organizatave të nxënësve është një mënyrë e mirë për t'i mësuar me demokracinë, për t'u dhënë mundësinë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur, për t'i mbajtur të përgjegjshëm për ndikimin e veprimeve të tyre për vet ata dhe për komunitetin përreth, për të adresuar në mënyrë efektive çështjet që prekin komunitetin e nxënësve në shkollë, etj. Liria e bashkimit në organizata dhe e mbledhjes paqësore është e drejtë e fëmijëve e sanksionuar me Konventë. Këshillat shkollore të nxënësve janë një nismë e mirë për t'i mësuar fëmijët të shfrytëzojnë këtë të drejtë. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës parasheh themelimin dhe funksionimin e këshillit të nxënësve në çdo shkollë të nivelit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Këshilli i nxënësve përbëhet nga së paku një përfaqësues i nxënësve nga secila klasë, që zakonisht janë pjesë e kryesisë së nxënësve të klasës. Aty specifikohet se roli i këshillit të nxënësve është të punojë në përmirësimin e mjedisit mësimor, kushteve të punës dhe interesave që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve si dhe të përfaqësohet në këshillin drejtues. Pra, një përfaqësues i këshillit të nxënësve është pjesë e Këshillit të Shkollës, që është organi më i lartë vendimmarrës në shkollë.

Përvojë personale:

Biri im ishte në klasën e gjashtë, kur një ditë erdhi në shtëpi dhe më tregoi se ishte zgjedhur kryetar i klasës. E pyeta se si ishte zgjedhur dhe ai më tregoi se ishte propozuar nga dikush nga klasa, krahas disa të propozuarve tjerë, se pastaj ishte organizuar një votim i hapur dhe se nxënësit kishin rënë në konflikt lidhur me dy nxënësit që dukeshin se kishin marrë më së shumti vota. Pastaj mësuesja kujdestare kishte marrë vendim që pasi nxënësit nuk mund të zgjedhnin vet, të caktonte birin tim si kryetar. Kur e pyeta nëse mësuesja paraprakisht i kishte diskutuar procedurat e zgjedhjes, ai më tha “jo”. Kur e pyeta se cilat do të ishin detyrat e tija si kryetar, ai me tregoi se do të duhej të mbikëqyrte situatën në klasë dhe nëse dikush bënte ndonjë gabim, ta shënonte emrin e tij/saj dhe ta raportonte te mësuesja kujdestare. U dëshpërova shumë kur arrita të përfundimi se shkolla po i bënte nxënësit spiunë në vend se të krijonte liderë prej tyre. Gjeta pak forcë që të mundohem ta bind birin tim se detyrat e vërteta të tija ishin që të përpqej ta mbante komunitetin e klasës në marrëdhënie të mira, të intervenonte në shmangien apo transformimin e konflikteve që mund të ndodhin, të ndihmonte vet dhe me të tjerët nxënësit në vështirësi në mësim, të adresonte çështje me rëndësi për nxënësit para mësueses kujdestare dhe menaxhmentit të shkollës, etj. I thashë se ai do të duhej ta përfaqësonte komunitetin e klasës dhe jo ta mbikëqyrte atë.

Fatkeqësisht praktikantët nëpër shkollat tona tregojnë se në shumicën e rasteve këshillat e nxënësve, por edhe organizimet tjera të fëmijëve, janë të themeluara formalisht dhe përmes procedurave që nuk janë aspak demokratike, por përkundrazi shpeshherë të imponuara nga mësuesdhënësit dhe menaxhmenti i shkollës. Këshillat e tilla të nxënësve në vend që denjësisht të përfaqësojnë interesat e nxënësve të shkollës, me tepër janë në funksion të kontrollit të nxënësve nga mësuesdhënësit dhe menaxhmenti i shkollës. Ato në vend që të ushqejnë përfaqësimin demokratik, më tepër krijojnë ndarje dhe potencial për konflikt në mes të nxënësve. Këto janë rastet tipike kur në vend që të ketë pjesëmarrje të vërtetë dhe kuptimplotë, ka pjesëmarrje fiktive, tokenizim dhe manipulim të fëmijëve. Këto praktika duhet të ndryshojnë dhe rol të rëndësishëm në këtë drejtim kanë mësuesdhënësit dhe prindërit.



Një doracak për komitetet shkollore për të drejtat e njeriut, i përgatitur në kuadër të një projekti që kishte në fokus fuqizimin e fëmijëve për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e tyre jep disa ide praktike për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe aktiviteteve që mund t'i zhvillojnë fëmijët brenda strukturave të këtylla të nxënësve. Doracaku mund të shkarkohet në:

<http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/05/Shqip-2.pdf>.

4.4 Përfshirja e prindërve në shkollë si stimulim për pjesëmarrjen e fëmijëve

Tashmë jemi bindur se përfshirja e prindërve në arsimimin e fëmijës është e rëndësishme së veçantë. Kur prindërit përfshihen në arsimimin e fëmijëve të tyre, fëmijët kanë gjasa të dalin më të suksesshëm në mësim, të kenë sjellje më të mira, të kenë qëndrime më pozitive për shkollën dhe të rriten për të qenë më të suksesshëm në jetë. Në fund të fundit, përfshirja e prindërve në punët e shkollës nxit interesimin dhe ndikon si stimulim për pjesëmarrje aktive të vet nxënësve në çështjet që lidhen me jetën shkollore. Kjo është kështu sepse fëmijët e ndjejnë atmosferën e një shkolle të hapur ndaj secilit.

Disa nga mënyrat se si të përfshiheni si prindër në shkollë:

- Merrni pjesë në takimin e fillimvitit – Njihuni me mësuesdhënësit dhe personelin tjetër të shkollës. Dëgjoni planet e tyre, kuptoni se çfarë duan të arrijnë me nxënësit e tyre dhe pse i kanë zgjedhur këto qëllime.
- Mësoni se çfarë ofron shkolla – Lexoni informatat që shkolla i dërgon në shtëpi. Bisedoni me prindër të tjerë për të kuptuar se çfarë programesh ofron shkolla. Mund të ketë ndonjë program muzikor, aktivitete jashtëmësimor, ekip sportiv, program tutorimi apo mbështetjeje tjetër që fëmijës suaj do t'i pëlqente. Mbani shënime për ngjarjet gjatë gjithë vitit shkollos.

- Merrni pjesë në ngjarjet shkollore – Shkoni në ngjarjet sportive apo koncerte, në ekspozita të nxënësve, mbrëmje bamirësie, etj.
- Merrni pjesë në takimet me prindër - Takimet e këshillit të prindërve ju japin mundësi të mira që të bisedoni me prindër tjerë dhe të punoni së bashku për të përmirësuar shkollën, ashtu sikurse edhe të artikulonit shpresat dhe brengat lidhur me fëmijën tuaj dhe shkollën. Merrni pjesë apo edhe ndihmoni në organizimin e takimit të prindërve me mësimitdhënës. Diskutoni hapur, kërkoni informata, jepni ide e propozime.
- Kontribuoni vullnetarisht në shkollën e fëmijës suaj – Nëse agjenda juaj e lejon, kërkoni mënyra për të ndihmuar në shkollën e fëmijës suaj. Shpesh shkollës mund t’u duheni si vullnetarë që ta ndihmoni në aspekte të ndryshme, si: të merrni pjesë si përfaqësues i prindërve në ndonjë komision të shkollës; të ndihmoni në klasën e fëmijës suaj, në bibliotekën e shkollës, apo në bufenë e shkollës; të përgatisni ushqim për ndonjë ngjarje të shkollës, të ofroni tutorim për nxënësit në fusha të ndryshme mësimore, si matematikë, lexim, teknologji informative, etj. Nëse, puna apo obligimet tuaja të tjera e pamundësojnë vullnetarizmin në shkollë, kërkoni mënyra që të kontribuoni prej shtëpisë. Për shembull, ju mund të ndihmoni në përkthimin apo editimin e letrës informative të shkollës.

Përvojë personale:

Në një takim të prindërve të klasës me mësuesen kujdestare, ajo krahas informatave tjera për aktivitetet në klasë, na tregoi se çdo muaj zgjedhet një nxënës i dalluar i klasës. Më tutje, ajo tregoi se këtë muaj kanë pasur vështirësi ta zgjedhin nxënësin për t’i dhënë këtë mirënjohje pasi janë mbi 10 nxënës që kanë rezultate maksimale në mësim. Unë e morra fjalën dhe pyeta nëse sukcesi i nxënësve në mësim është kriteri i vetëm për t’i dhënë një nxënësi mirënjohjen si i/e dalluar. Ajo, si duke u shfaqësuar tha se kështu kishin bërë deri tash. Atëherë unë pyeta “A nuk duhet që i dalluar të shpallej një nxënës i klasës që ndihmon dikë në rrugë, a bën një vepër tjetër të mirë? Apo, a nuk duhet që kjo mirënjohje t’i shkoj Gjinit, një nxënësi të klasës që kishte përgatitur ueb faqen e shkollës?”. U interesova edhe rreth asaj se kush vendos për nxënësin e dalluar të muajit. Mësuesja tregoi se këtë e zgjedhin mësimitdhënësit. Edhe lidhur me këtë pata një reagim, duke thënë se kjo është një mundësi e mirë që nxënësve t’u jepej pronësia në këtë proces, pra, që ata të propozonin dhe të përzgjedhnin nxënësin e dalluar.

4.5 Pjesëmarrja e fëmijëve në bashkëpunimin familje – shkollë

Duke qenë se fëmijët kalojnë pjesën më të madhe të kohës në familje apo shkollë, jo vetëm që është e rëndësishme se si këto institucione e perceptojnë pjesëmarrjen, por po ashtu deri në çfarë mase ato koordinohen në promovimin e pjesëmarrjes së fëmijëve. Nuk është e mjaftueshme që fëmijët të marrin pjesë vetëm në këshillat e nxënësve apo projektet në klasë apo shkollë. Pjesëmarrja domethënëse e fëmijëve nënkupton që jeta shkollore është tërësisht e përshkruar me parime të pjesëmarrjes. Pjesëmarrja e fëmijëve dhe veprimi bashkëpunues duhet të reflektohet në jetën e përditshme në shkollë, në modelet e komunikimit në shkollë dhe në marrëdhëniet prind – mësimitdhënës – nxënës. Prandaj, është shumë e rëndësishme përfshirja e fëmijëve në bashkëpunimin familje - shkollë.

Cilësia e bashkëpunimit familje – shkollë dhe rrethanat në të cilat zhvillohet përcaktojnë nëse të drejtat e pjesëmarrjes respektohen apo mohohen. E kriteri kryesor i cilësisë së këtij bashkëpunimi është pikërisht shkalla e pjesëmarrjes aktive të fëmijëve në vet këtë bashkëpunim. Qëllim parësor i bashkëpunimit familje – shkollë është mirëqenia e fëmijës, prandaj fëmijës duhet t'i jepet rol aktiv në situata të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë në mes të familjes dhe shkollës, në dritën e nenit 12 të Konventës, i cili thekson të drejtën e fëmijëve që të shprehin lirshëm pikëpamjet e tyre në lidhje me çështjet që kanë ndikim në ta. Prandaj duhet të krijohen praktika të pjesëmarrjes së fëmijëve, që demonstron pjesëmarrje aktive të fëmijëve në bashkëpunimin familje – shkollë, ku jo vetëm që shprehin pikëpamjet e tyre, por edhe argumentojnë ato pikëpamje, propozojnë zgjidhje, e madje edhe organizojnë vet takime familje – shkollë. Praktikrat e këtilla jo vetëm që mbrojnë interesin më të mirë të fëmijëve, por edhe përkrahin një vendimmarrje të zgjeruar, pasi fëmijët kanë njohuri unike për veten, për të cilat të rriturit mund edhe të mos jenë të vetëdijshëm.

5. Ide për veprim

Vitet e para të jetës janë kritike për zhvillimin e fëmijëve dhe rolin vendimtar në këtë proces e luan fillimisht familja, e më vonë edhe mësuesdhënësit e personeli tjetër në shkollë, por edhe të rriturit e tjerë të cilët janë pjesë e jetës së fëmijëve. Prandaj është e rëndësishme që si prindër dhe mësuesdhënës të ofrojmë mundësi të shumta që zhvillojnë tek fëmijët njohuri rreth të drejtave dhe përgjegjësi të tyre dhe t'i ndihmojmë ata që këto të drejta dhe përgjegjësi t'i bëjnë pjesë të pandashme të jetës së tyre. MacNaughton et al. (2003)³ argumentojnë se fëmijët që nga mosha e hershme kanë aftësi dhe dëshirë të shprehin pikëpamjet e tyre në lidhje me gjërat që kanë ndikim tek ata. Autorët po ashtu theksojnë se fëmijët duhet të inkurajohen dhe përkrahin me qëllim të zhvillimit të njohurive dhe aftësive që u shërbejnë atyre të jenë qytetarë dhe pjesëmarrës aktiv në proceset vendimmarrëse.

Në mënyrë që t'i zhvillojmë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e fëmijëve në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, si prindër dhe mësuesdhënës duhet të krijojmë kushte të përshtatshme të cilat nxisin fëmijët të mendojnë rreth këtyre temave dhe rëndësisë së tyre. Në anën tjetër është po ashtu e rëndësishme që prindërit e të rriturit e tjerë që luajnë rol në rritjen e fëmijëve, si dhe mësuesdhënësit, të familjarizohen me konceptet që burojnë nga Konventa e të Drejtave të Fëmijëve dhe të veprojnë bazuar në këto të drejta.

Në faqet në vijim janë prezantuar disa aktivitete praktike të cilat mund të organizohen nga prindërit dhe mësuesdhënësit për të zhvilluar njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e fëmijëve karshi të drejtave dhe përgjegjësi të tyre.

³ MacNaughton, G., Smith, K. and Laërence, H. (2003) ACT Children's Strategy - Consulting with Children Birth to Eight Years of Age. Hearing Young Children's Voices. Children's Services Branch, ACT Department of Education, Youth and Family Services.



Vizualizimi i të drejtave të fëmijëve

Ky aktivitet mund të realizohet në fazat e para kur filloni trajtimin e të drejtave të fëmijëve me nxënësit apo fëmijët tuaj. Aktiviteti ka për qëllim prezantimin e të drejtave të fëmijëve dhe nxitjen e nxënësve që të mendojnë më shumë rreth të drejtave të tyre.

Bëni bashkë një numër të fotografive të cilat ilustrjnë të drejtat e fëmijëve. Këto fotografi mund t'i gjeni në internet, revista apo burime të tjera. Më pas shkruani disa fjali të cilat paraqesin të drejtat e fëmijëve nga Konventa. Është mirë që teksti i neneve të Konventës të përshtatet sipas nivelit të nxënësve/fëmijëve në mënyrë që të jetë sa më i qartë për ata.

Kërkoni nga fëmijët që të lidhin fotografitë me fjalitë dhe më pas diskutoni rreth tyre.

Variacion:

Me moshat më të vogla, për të përmbyllur aktivitetin, mund të kërkoni që fëmijët të përzgjedhin njërin nga të drejtat dhe ta paraqesin përmes ilustrimit.

Me moshat më të rritura kërkoni nga fëmijët që të përzgjedhin njërin nga fjalitë (nenet) dhe të shënojnë disa hapa konkretë që mund t'i ndërmarrin ata për të zbatuar dhe promovuar atë të drejtë.

Në të dy rastet përmbylleni aktivitetin me një reflektim përmbledhës duke u dhënë nxënësve/fëmijëve kohë që të prezantojnë punën e tyre dhe duke dhënë komente sipas nevojës.

Ky aktivitet mund të përdoret nga prindërit dhe mësime dhënësit. Në rastin e fundit mund ta realizoni aktivitetin në formë të punës grupore.

Kutia sekrete

Kutia sekrete mund të bëhet pjesë e klasës për të grumbulluar shembujt e mirë të respektimit të të drejtave dhe përgjegjësisë. Përmes këtij aktiviteti ju i nxisni nxënësit që të mendojnë rreth të drejtave përmes vëzhgimit të sjelljes së tyre dhe të personave të tjerë rreth tyre, si dhe duke u krijuar atyre mundësi që të reflektojnë rreth mënyrës se si sillemi.

Fillimisht organizoni një diskutim dhe bashkërisht me nxënësit bisedoni rreth vlerave të ndryshme si respekti, toleranca, ndihma, solidariteti, diversiteti dhe tema të ngjashme. Nëse nxënësit nuk kanë njohuri rreth këtyre koncepteve atëherë prezantoni kuptimin e tyre dhe më pas nixini nxënësit që të reflektojnë dhe të kujtojnë raste konkrete kur kanë dëshmuar respektimin e këtyre vlerave apo kur vet ata kanë promovuar këto vlera. Për të prezantuar konceptet e reja mund të shfrytëzoni fotografi të ndryshme, lojën me asociacione apo ndonjë aktiviteti tjetër.

Më pas tregojuni nxënësve për Kutinë Sekrete dhe qëllimin e saj. Madje mund të organizoni bashkë me nxënësit krijimin dhe zbukurimin e një kutie duke ripërdorur materiale të ndryshme.

Inkurajoni nxënësit që të vëzhgojnë veten dhe të tjerë për një kohë të caktuar dhe të shënojnë rastet personale kur respektojnë të drejtat dhe përgjegjësitë ose rastet që i dëshmojnë të tjerët. Çdo herë kur nxënësit vërejnë një shembull pozitiv tek vetja apo të tjerët duhet ta shënojnë menjëherë shembullin dhe më pas ta vendosin në kuti.

Pas një kohë (për shembull pas një muaji), bashkë me fëmijët hapni kutinë, lexoni shembujt e dhënë dhe diskutoni rreth tyre. Po ashtu mund t'i nxisni nxënësit që t'i ilustrjnë këta shembuj përmes vizatimeve, apo formave të tjera të të shprehurit dhe të krijojnë një galeri për klasën tuaj.

Kutia sekrete mund të praktikohet edhe nga prindërit dhe të shfrytëzohet nga të gjithë anëtarët e familjes si dhe vizitorët e tjerë.

Uebfaqja <http://www.aces.or.at/methods> ofron një mori aktivitetesh që mund të organizohen me nxënësit të cilat trajtojnë tema të ndryshme si solidariteti, diversiteti, dialogu ndërkulturor e të ngjashme. Bashkëpunoni me mësime dhënësit e gjuhës angleze për t'iu qasur më lehtë këtyre materialeve dhe organizoni së bashku aktivitete për nxënësit tuaj.

Nxënësi për nxënësin

Shpeshherë thuhet se mënyra më e mirë për të mësuar diçka është duke i mësuar të tjerët. Krijoni mekanizma në shkollë të cilat nxënësit më të rritur t'i prezantojnë të drejtat e fëmijëve të nxënësit më të vegjël dhe t'i udhëheqin në praktikimin e tyre. Bashkëpunoni me nxënësit që të krijojnë një plan të punës dhe diskutoni rreth mënyrës se si do t'i realizojnë aktivitetet varësisht nga niveli i nxënësve me të cilët do të punojnë (p.sh. te klasat më të ulta mund të përdorin lojëra të ndryshme, vizatimin apo krijimin e tregimeve, ndërkaq me nxënësit më të rritur mund të përgatisin prezantime, broshura apo të përdorin teknika të tjera).

Në fund të aktivitetit kërkoni nga nxënësit që të përgatisin prezantime ku përshkruajnë punën që e kanë bërë, gjërat që kanë mësuar dhe si janë ndier. Këto prezantime mund t'i bëjnë për shokët dhe shoqet e klasës apo edhe për një publik më të gjerë.

Përmes këtij aktiviteti nxënësit mësojnë më shumë rreth të drejtave të fëmijëve si dhe zhvillojnë aftësitë për planifikim, menaxhim, bashkëpunim, reflektim e prezantim.

Dizajno projektin tënd dhe bëje realitet

Mësuesit dhe prindërit mund të bashkëpunojnë për të realizuar një projekt të përbashkët me nxënësit. Disa nga projektet e mundshme janë realizimi i një shfaqje, vallëzimi, ekspozite, ore letrare, fushate për ngritje fondesh apo diçka të ngjashme që ka në fokus të drejtat e fëmijëve.

Një ngjarje e tillë mund të organizohet përgjatë disa muajve duke i përfshirë nxënësit në të gjitha hapat e planifikimit. Disa nga hapat që mund të ndërmerrni në bashkëpunim me nxënësit:

- ❑ Diskutoni rreth kësaj ideje dhe vendosni bashkërisht llojin e projektit që dëshironi të realizoni;
- ❑ Krijoni ditarin e aktiviteteve dhe shënoni të gjitha aktivitetet që dëshironi të organizoni, qëllimet e tyre, hapat që duhet të ndërmerrni dhe personat që mund t'ju ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve (p.sh. prindërit, ndonjë organizatë joqeveritare, profesionistë të fushave të ndryshme si aktorë, piktorë, shkrimtarë, etj.);
- ❑ Bazuar në informatat që dalin nga ditari i aktiviteteve përcaktoni kohëzgjatjen e tërë projektit;
- ❑ Realizoni aktivitetet e parapara me fëmijët dhe me ndihmën e partnerëve të projektit që i keni përcaktuar në hapin paraprak;
- ❑ Shënoni përfundimin e projektit me një organizim i cili paraqet punën e fëmijëve dhe prezantoni atë para një publiku;

Ky aktivitet mund të zhvillohet me grupmosha të ndryshme të fëmijëve duke i përshtatur aktivitetet e projektit me njohuritë, shkathtësitë dhe potencialin e fëmijëve. Përmes realizimit të këtij aktiviteti fëmijët jo vetëm që do të mësojnë më shumë rreth të drejtave dhe përgjegjësi të tyre, por edhe do të zhvillojnë shkathtësi për t'i promovuar ato.

Ditët e veçanta

Krijojeni një kalendar dhe shënoni ditët e veçanta. Shfrytëzoni këto ditë për të realizuar aktivitete të ndryshme të cilat promovojnë të drejtat e fëmijëve.

Disa nga ditët e veçanta të identifikuara nga UNICEF:

Dita e Kancerit të Fëmijëve (15 shkurt) - një ditë për të realizuar aktivitete të cilat shënojnë ditën ndërkombëtarë të kancerit të fëmijëve dhe për të treguar përkrahje për fëmijët dhe familjet e prekura nga kjo sëmundje.

Ndërlidhja me të drejtat:

Neni 24: shëndeti dhe shërbimet shëndetësore

Dita Botërore e Librit (3 mars) - një ditë e përcaktuar nga UNESCO për të festuar librat dhe të lexuarit.

Ndërlidhja me të drejtat:

Neni 29: qëllimet e arsimimit

Dita për Vetëdijesim për Autizëm (2 prill) - një ditë që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes për autizëm me qëllim të inkurajimit të shteteve për ndërmarrjen e masave për diagnostikim dhe ndërhyrje që në fazat e hershme.

Ndërlidhja me të drejtat:

Neni 2: mos-diskriminimi

Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve (1 qershor) - Konferenca Botërore për Mirëqenien e Fëmijëve në Gjenevë, Zvicër në vitin 1925 ka caktuar 1 Qershorin si Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.

Ndërlidhja me të drejtat:

Konventa në tërësi.

Për të parë listën e plotë të publikuar nga UNICEF shikoni veglën 'Linking Events to Rights' te pjesa e Burimeve Informative.

Të drejtat më të çmueshme

Mësuesdhënësit dhe prindërit përmes këtij aktiviteti mund t'i inkurajojnë nxënësit që të mendojnë më shumë rreth të drejtave që kanë ata dhe rëndësisë së tyre.

Krijoni një listë me dhjetë fjali të cilat burojnë nga Konventa e të Drejtave të Fëmijëve. Ndajini nxënësit në grupe dhe shpërndani listën me fjali te secili grup.

Kërkoni nga nxënësit që të diskutojnë për secilën fjali me radhë duke dhënë arsye se pse ata i konsiderojnë të rëndësishme ato të drejta. Më pas kërkoni nga nxënësit që si grup të përzgjedhin tri deklarata nga lista të cilat ata i konsiderojnë si më të çmueshmet. Inkurajoni nxënësit që të japin të paktën tri argumente për zgjedhjen e tyre.

Pasi që nxënësit të kenë zgjedhur tri të drejtat që ata i konsiderojnë si më të vlefshmet, kërkoni nga secili grup me radhë të tregojnë vendimin e tyre duke e elaboruar përzgjedhjen që kanë bërë. Në fund kërkoni nga secili grup që të përcaktojnë një numër të përgjegjësive që kanë ata karshi të drejtave që kanë përzgjedhur si më të rëndësishme.

Ky aktivitet përveç se i ndihmon nxënësve të mendojnë më shumë rreth të drejtave dhe përgjegjësive të tyre, po ashtu u ofron atyre mundësi që të artikulojnë mendimet e tyre duke dhënë argumenteve dhe të vijnë në një përfundim të përbashkët si grup përmes diskutimit.

Këtu janë dhënë disa deklarata si shembull, megjithatë fjalitë duhet të përgatiten në përputhshmëri me nivelin e nxënësve dhe njohuritë paraprake të tyre.

Dua të kem të drejtë të shpreh mendimin tim për çështjet që kanë ndikim tek unë.

Dua të rritem në një mjedis të pastër.

Dua të kem qasje në informata të besueshme.

Dua të kem qasje në arsimim cilësor që zhvillon aftësitë dhe talentet e mia në maksimumin e potencialit tim.

Dua të jem i/e lirë të zgjedh se në cilat grupe apo organizata dua të marr pjesë.

Prindërit mund ta përdorin këtë aktivitet në shtëpi për të nxitur diskutimin me fëmijët e tyre karshi të drejtave dhe përgjegjësive që kanë ata.

Detektivët e të drejtave dhe përgjegjësi të fëmijëve

Ky aktivitet u mundëson nxënësve që të identifikojnë rastet pozitive kur të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve janë respektuar nga vet ata si bashkëmoshatarë, por edhe nga të rriturit dhe t'i paraqesin ato përmes formave të ndryshme të të shprehurit.

Pasi që të diskutoni me nxënësit rreth përgjegjësi dhe të drejtave të tyre kërkoni nga ata që përgjatë një jave të vëzhgojnë mjediset ku ata e kalojnë kohën më të madhe të tyre (për shembull shkollën, lagjen, klubet sportive, platformat online) dhe të mbajnë shënime rastet kur të drejtat dhe përgjegjësitë janë respektuar.

Pas një jave ndani nxënësit në grupe në mënyrë që të diskutojnë rreth të gjeturave të tyre. Më pas kërkoni nga ata që të gjeturat e tyre t'i paraqesin përmes posterëve, librave të vegjël, poezive, broshurave apo materialeve të tjera promovuese. Materialet e punuara nga nxënësit mund të ekspozohen në hapësirën e klasës, shkollës, në ueb faqen e shkollës apo edhe të organizohet një ekspozitë që prezantohet para një publiku më të gjerë.

Nxënësit mund t'i punojnë këto materiale promovuese përmes vizatimit, duke përdorur materiale të ndryshme që mund të ripërdoren, apo edhe përmes ndonjë programi kompjuterik. Në rastin e fundit disa vegla online të cilat mund t'ju shërbejnë, që janë lehtë të përdorshme dhe që kanë disa apo të gjitha funksionet pa pagesë janë dhënë më poshtë.

www.easel.ly

www.storyjumper.com

www.powtoon.com

www.canva.com

www.smore.com

Hulumtuesit e rinj

Ky aktivitet realizohet përgjatë një periudhe kohore dhe u jep nxënësve mundësi që të zhvillojnë aftësitë për hulumtim duke trajtuar në të njëjtën kohë tema që ndërlidhen me të drejtat e fëmijëve.

Të mësuarit përmes hulumtimit është formë e të nxënësve aktiv e cila i nxit nxënësit që të parashtrojnë pyetje apo probleme, të grumbullojnë të dhëna për pyetjet e parashtruara, t'i analizojnë të dhënat dhe të vijnë në përfundime bazuar në të gjeturat e tyre. Rekomandohet që këtë aktivitet ta realizoni pasi që nxënësit të janë prezantuar me të drejtat e fëmijëve dhe pas zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme për t'i nxituar ata që të mendojnë dhe reflektojnë më shumë rreth kësaj teme.

Ndani nxënësit në grupe dhe secilit grup caktojani një temë që del nga Konventa (p.sh. arsimimi, shëndeti, mosdiskriminimi). Kërkoni nga ata që të përpilojnë disa pyetje që ndërlidhen me fushën e tyre. Më pas kërkoni që të diskutojnë rreth rëndësisë që ka secila pyetje duke eliminuar kështu opsionet dhe duke përzgjedhur vetëm njërin nga pyetjet për hulumtim.

Prezantoni nxënësit me instrumentet e ndryshme që shërbejnë për mbledhjen e të dhënave, si pyetësi, shqyrtimi i dokumenteve të ndryshme apo intervistat, dhe mënyrës se si realizohen ato.

Është mirë që nxënësit të lexojnë më shumë rreth fushës që kanë zgjedhur para se të përgatisin pyetjet që do t'i përfshijnë në intervista apo pyetësorë dhe para se të fillojnë realizimin e hulumtimit. Organizoni me nxënësit një orë në kabinet të teknologjisë për të hulumtuar në internet në mënyrë që të informohen më shumë rreth temave që kanë përzgjedhur (në mungesë të infrastrukturës mund të kërkoni nga nxënësit që të hulumtojnë në shtëpi dhe pastaj të diskutoni në klasë rreth të gjeturave të tyre).

Kërkoni nga secili grup që të përcaktojnë mënyrën se si do t'i grumbullojnë të dhënat për të gjetur përgjigjen e pyetjes së hulumtimit që kanë parashtruar. Po ashtu, nxënësit duhet të përcaktojnë se me kë do ta realizojnë hulumtimin (p.sh. nxënësit e tjerë, qytetarët e ndryshëm, familjarët e tyre, mësime dhënësit) dhe sa pjesëmarrës do të jenë pjesë e hulumtimit të tyre. Në rastin e intervistave është mirë që të përzgjedhet një numër më i vogël i personave, ndërkaq në rastin e pyetësorëve rekomandohet që të përfshihen më shumë. Pasi që nxënësit të kenë përcaktuar pyetjet e intervistave apo pyetësorëve, apo dokumentet që dëshirojnë t'i analizojnë, ata mund ta realizojnë hulumtimin e tyre. Kërkoni nga nxënësit që të regjistrojnë intervistat, dhe të fotografojnë punën e tyre gjatë hulumtimit.

Nxënësit bëjnë analizimin e të dhënave dhe i paraqesin ato përmes grafikoneve, tabelave apo ndonjë forme tjetër. Nxënësit mund të shkruajnë një raport rreth të gjeturave të tyre apo edhe t'i prezantojnë ato në ndonjë formë tjetër duke përfshirë edhe fotografi të aktiviteteve që kanë realizuar ata.

Të proklamojmë të drejtat tona

Debatet e organizuara me nxënës ofrojnë mundësi për përfundimin e shkathtësive reflektuese, argumentuese, e po ashtu për t'u shprehur në publik, për të menduar në mënyrë kritike dhe për t'u bërë dëgjues aktiv. Prandaj, metodën e debatit mund ta përdorni për të zhvilluar këto shkathtësi të nxënësit, por edhe për t'i inkurajuar ata që të mendojnë më shumë rreth të drejtave të fëmijëve duke reflektuar në mënyrë aktive rreth tyre.

Formoni katër grupe të nxënësve. Tri grupe përfshihen në debat ndërsa grupi i katërt jo, pasi anëtarët e këtij grupi gjatë kësaj kohe shërbejnë si audiencë, pra si persona të cilët duhet të binden nga grupet përmes argumentimit. Ky është grupi vlerësues.

Përgatitni paraprakisht fletat të vogla ku shënoni deklaratat që lidhen me të drejtat e fëmijëve (për shembull: Çdo fëmijë ka të drejtë të ushqehet shëndetshëm; Çdo fëmijë ka të drejtë të luaj; Çdo fëmijë ka të drejtë të ketë përkujdesje të mirë shëndetësore; etj.)

Para se nxënësit ta fillojnë punën prezantojuni atyre strukturën e debatit, ecurinë e tij dhe çfarë pritet nga ata (një model i strukturës është dhënë në faqen vijuese). Kështu nxënësit do të jenë më të fokusuar gjatë përgatitjes së fjalimeve të tyre. Shkathtësitë e debatit zhvillohen gradualisht prandaj ofrojuni nxënësve mundësi të shumta për t'i përfunduar ato.





Secili nga tre grupet e tërheq një fletë ku është e shënuar një deklaratë. Tregojuni nxënësve që kanë 10 minuta kohë të përgatisin një fjalim treminutësh për të proklamuar të drejtën e tyre si mbizotëruese apo prioritarë në krahasim me ato të grupeve tjera dhe pse pikërisht ajo e drejtë duhet të respektohet me çdo kusht. Gjatë kohës që nxënësit përgatisin fjalimin, grupi vlerësues viziton grupet dhe përcjell punën e tyre.

Kërkojuni grupeve që të ofrojnë me radhë fjalimin e tyre treminutësh duke e dhënë një përshkrim të shkurtër të deklaratës që kanë përzgjedhur dhe duke dhënë argumentet për rëndësinë e saj dhe, mundësisht, duke i shoqëruar këto argumente me shembuj. Nxënësit përmbyllin fjalimin me një fjali përmbledhës duke ripërsëritur pikat kyçe që kanë prezantuar.

Pas raundit të parë nxënësit kanë kohë deri në 10 minuta që të përgatiten për raundin e dytë. Në raundin e dytë grupet gjatë 3 minutave japin vërejtjet në argumentet e dhëna nga grupi në vijim (p.sh. grupi 1 për grupin 2, grupi 2 për grupin 3 e grupi 3 për grupin 1) si dhe japin argumente shtesë për të drejtën që e përfaqësojnë duke përfunduar kështu pozitën e tyre.

Në vijim kërkoni nga grupi vlerësues të bëjë një vlerësim të fjalimeve dhe argumenteve të ofruara nga tri grupet duke marrë edhe vendimin për radhitjen e fjalimeve. Grupi vlerësues duhet po ashtu të arsyetojë vlerësimin dhe vendimin e vet duke treguar cilat ishin elementet në të cilat u bazuan më së shumti gjatë vlerësimit.

Kërkojuni nxënësve të çlirohen nga atmosfera e debatit dhe të ulen në rreth. Bëni një diskutim përmbledhës për aktivitetin duke filluar me ndjenjat gjatë aktivitetit, elementet e të mësuarit nga kjo përvojë dhe mënyrën se si mund ta shfrytëzojnë këtë mësim në të ardhmen, në situata jetësore. Përpiquni që gjatë diskutimit lidhur me elementet e të mësuarit dhe diskutimin për të drejtat e fëmijëve, të vini te përfundimi se të gjitha të drejtat janë të rëndësishme dhe ne si qenie njerëzore nuk jemi të plotësuar nëse gëzojmë vetëm një pjesë të tyre, ndërsa na mungojnë një pjesë tjetër e tyre. Të drejtat e njeriut kanë kuptim vetëm si një tërësi e të drejtave.



6. Shembuj të praktikave të mira

“Bëhu ti ndryshimi që dëshiron ta shohësh në botë”.

Gandhi

Secili nga ne mund të angazhohet përmes formave të ndryshme që të kontribuojë në zhvillimin, përkrahjen dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Ndërmarrja e ndonjë aksioni humanitar, angazhimi si vullnetarë në ndonjë organizatë jo qeveritare, avokimi, nxitja e institucioneve përmes aktiviteteve të ndryshme apo thjeshtë diskutimi më i madh për të drejtat e fëmijëve janë vetëm disa forma të cilat mund të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes qytetare dhe institucionale karshi respektimit dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve. Më poshtë janë dhënë disa shembuj të iniciativave të ndryshme të cilat trajtojnë çështjet e të drejtave të fëmijëve në mënyra dhe këndvështrime të ndryshme.

Korniza Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve

Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve në Indonezi është një iniciativë e përbashkët e Universitetit të Kolumbisë, Universitetit të Indonezisë dhe UNICEF e cila është themeluar me qëllim të përmirësimit të sistemit për mbrojtjen e fëmijëve në Indonezi përmes krijimit të një kornize kombëtare që trajton këtë çështje. Korniza shërben për përmirësimin e programeve dhe politikave të hartuara për mbrojtjen e fëmijëve.

Për më shumë kjo qendër synon që të zhvillojë kapacitet e akademikëve dhe personave të tjerë që hartojnë politika për strukturimin e modeleve për zhvillimin e projekteve të cilat bazohen në të gjeturat nga hulumtimet.

<http://www.puskapa.org/>

Përdorimi i teknologjisë për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në avokimin për të drejtat e fëmijëve

Kjo iniciativë e cila zhvillohet në Libanon nga Rrjeti Manara për Të Drejtat e Fëmijëve dhe Save the Children Suedi është përzgjedhur si praktikë e mirë sepse përfshin vet fëmijët në krijimin e mesazheve të cilat synojnë ngritjen e vetëdijes dhe rrisin mbështetjen për të drejtat e fëmijëve. Përmes shfrytëzimit të teknologjisë dhe duke përdorur animacionet fëmijët diskutojnë për temat që i shqetësojnë ata dhe po ashtu përdorin këtë formë të shprehjes për të edukuar fëmijët e tjerë dhe të rritur në lidhje me çështjet të cilat janë të rëndësishme për jetën e tyre.

Në të njëjtën kohë fëmijët pjesëmarrës fitojnë shkathtësi që nevojiten për krijimin e animacioneve përmes teknologjisë, shkruajnë tregimet e tyre dhe krijojnë personazhe të cilat tregojnë historitë e tyre.

[http://www.nabaa-lb.org/project2/en/Manara-Network-\(Child-Rights-Network\)](http://www.nabaa-lb.org/project2/en/Manara-Network-(Child-Rights-Network))

<http://www.savethechildren.se/>

Arsimimi themelor dhe zhvillimi i fëmijës përmes të mësuarit aktiv duke përdorur sportet dhe lojën

E drejta për arsimim, shëndet dhe lojë, të përfshira në Konventë si të drejta që secili fëmijë duhet t'i gëzojë, janë në fokus të organizatës Right to Play (E Drejta për të Luajtur). Kjo organizatë promovon pikërisht lojën dhe sportin si mjet për të arritur këto të drejta. Sipas organizatës koha e lojës dhe argëtimi janë faktor të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve në aspektin emocional dhe njohës. Right to Play promovon sportin si një mjet për t'i bërë fëmijët më tolerantë, të durueshëm dhe bashkëpunues, si dhe udhëheqës më të mirë.

Organizata arrin qëllimet e saja përmes hartimit të materialeve të ndryshme udhëzuese për përdorimin e kësaj teknike dhe trajnimit të udhëheqësve, trajnerëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të cilët synojnë të zbatojnë këtë metodë të të nxënësve.

<http://www.righttoplay.com/>

Fushata ‘Ka të bëjë me aftësinë’ për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Fushata ‘Ka të bëjë me aftësinë’ e realizuar nga Qeveria e Malit të Zi dhe UNICEF kishte për qëllim zhvillimin e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të njerëzve rreth gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kampanja po ashtu kishte për qëllim sigurimin e qasjes në shërbime cilësore dhe edukim për të gjithë pa diskriminim.

Kjo fushatë ka arritur që të pesëfishojë numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollë, ka kontribuar në përmirësimin e sistemeve për përkujdesjen e fëmijëve dhe ka ndërtuar qendra të reja për përkujdesje ditore.

Një hulumtim vlerësues i realizuar vetëm tri vite pas fillimit të fushatës gjeti se kjo fushatë kishte ndikuar pozitivisht në disa aspekte. Vetëm gjatë periudhës gusht 2010 – dhjetor 2013, përqindja e qytetarëve të cilët e konsideronin të papranueshme që fëmijët me aftësi të kufizuara të jenë nxënës në të njëjtën klasë me fëmijët e tyre, u zvogëlua nga 64 % në 20 %. Po ashtu përqindja e qytetarëve të cilët më parë e kishin konsideruar të papranueshme që fëmijët e tyre të shoqërohen me fëmijë me aftësi të kufizuara është zvogëluar për rreth 30%.

Avokimi dhe përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha aktivitetet e fushatës ka ndihmuar që kjo fushatë të dalë e suksesshme.

<https://www.unicef.org/montenegro/15868.html>

Sigurimi i një linje ndihmëse për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët dhe programet e shkollave speciale për të rinjtë në rrezik dhe delikuentë

Linja këshilluese për fëmijë, e siguruar nga organizata joqeveritare Brave Phone në Bosnjë dhe Hercegovinë, shërben për të pranuar thirrje telefonike të cilat kanë për qëllim të mbrojnë fëmijët nga abuzimi dhe në të njëjtën kohë ofron ndihmë për prindërit. Kjo linjë po ashtu ofron këshilla rreth formave të dhunës, karakteristikave që dëshmojnë se fëmijët janë neglizhuar dhe këshilla të tjera që kanë të bëjnë me sfidat e ndryshme të cilat mund të dërgojnë deri në shpërbërjen e familjes. Po ashtu, linja telefonike ofron informata rreth burimeve të cilat janë në dispozicion në nivelin lokal si policia, personeli mjekësor e të ngjashme. Psikologët, punonjësit social dhe studentët e edukimit angazhohen si vullnetarë për të ofruar këshilla përmes kësaj linje. Brave Phone përgatit vullnetarët në mënyrë që të jenë të gatshëm për ofrimin e këshillave.

Të gjitha shërbimet janë pa pagesë dhe anonime.

<http://www.hrabiteltelefon.hr/o-nama/programi>

Ka edhe shumë praktika të tjera të cilat trajtojnë çështjen e të drejtave të fëmijëve në nivele dhe forma të ndryshme. Disa prej tyre janë të përmbledhura në dokumentet në vijim:

<http://www.protectionproject.org/wp-content/uploads/2014/01/Best-Practices-in-Child-Protection-2013.pdf>

https://www.unicef.org/eca/UNICEF_Compndium_of_promising_practices_Web.pdf



7. Burime informimi

Vegëza te ndryshme që mund t'u shërbejnë prindërve dhe mësime të mësimdhënësve në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve

Burimet e informatave në gjuhën shqipe në internet janë të kufizuara, veçanërisht kur bëhet fjalë për burimet të cilat mund të përdoren gjatë procesit mësues. Megjithatë, viteve të fundit, janë përgatitur një numër i konsiderueshëm i materialeve në gjuhën shqipe që adresojnë çështjet e të drejtave të fëmijëve me qëllim të promovimit të tyre dhe informimit më të mirë të mësime të mësimdhënësve, prindërve dhe akterëve të tjerë të përfshirë në procesin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve. Në gjuhën angleze, ndërkaq, ka mjaft burime të këtuilla, që janë shumë miqësore për përdoruesit.

Më poshtë janë përmbledhur disa burime të cilat mund t'ju shërbejnë juve mësime të mësimdhënësve dhe prindër të dashur që të trajtoni çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Këto materiale vijnë në formë të manualëve, udhëzuesve, mësimeve model e aktiviteteve praktike që mund të zbatohen me nxënës/fëmijë si dhe vegla tjera përfshirë filma vizatimorë dhe video, një lojë elektronike për fëmijë dhe materiale të tjera. Në kutitë me ngjyrë të kuqe i gjeni materialet në gjuhën shqipe, ndërkaq në ato me ngjyrë të kaltër kemi përmbledhur disa materiale në gjuhën angleze të cilat mund të përshtaten lehtë për t'u përdorur në kontekste të ndryshme.

Emri i veglës: Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Përshkrimi: Në këtë ueb faqe mund të lexoni në gjuhën shqipe Konventën për të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989.

Adresa: https://www.unicef.org/magic/media/documents/CRC_albanian_language_version.pdf

Emri i veglës: Edukimi për të Drejtat e Njeriut me Fëmijë

Përshkrimi: Doracak i botuar nga Qendra për Arsim e Kosovës i cili përmban aktivitete praktike që mund të realizohen me fëmijë/nxënës. Doracaku shfrytëzon metodologjinë e të mësuarit përmes përvojës dhe ka për qëllim fuqizimin e nxënësve përmes zhvillimit të njohurive, shkathtësive e qëndrimeve të tyre për të drejtat e njeriut. Programi i është përshtatur grupmoshave 12-15 vjeçare, por aktivitetet e doracakut shumë lehtë mund të adaptohen edhe për grupmoshat tjera.

Adresa: <https://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/03/Edukimi-per-te-drejtat-e-njeriut-me-femije.pdf>

Emri i veglës: Doracak për Komitetet Shkollore për të Drejtat e Fëmijës

Përshkrimi: Ky doracak nxit pjesëmarrjen aktive të nxënësve në aktivitetet e shkollës dhe marrjen e vendimeve të cilat kanë ndikim te nxënësit. Doracaku jep informata të detajuara dhe këshilla rreth mënyrës së funksionimit të Komiteteve Shkollore për të Drejtat e Fëmijëve dhe si organizohen ato. Përfshirja në Komitetet Shkollore për të Drejtat e Fëmijës po ashtu u ofron nxënësve mundësi që të zgjerojnë njohuritë dhe të fitojnë shkathtësi për pjesëmarrje aktive në çështjet të cilat luajnë rol në mirëqenien e nxënësve, në mjedisin shkollore e në komunitetin më të gjerë. Mësime të mësimdhënësve dhe prindërve mund të punojnë me këtë vegël për të kultivuar te nxënësit/fëmijët shkathtësitë që ndërliken me pjesëmarrjen aktive në shkollën e tyre përmes formimit të Komiteteve Shkollore për të Drejtat e Fëmijës (apo organizatave të ngjashme të nxënësve), duke ndikuar kështu drejtpërdrejt edhe në promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Adresa: <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/05/Shqip-2.pdf>

Emri i veprës: Të Drejtat e Fëmijës dhe Etika e Mësime dhënësit (Tekst Universitar për Studentë të Fakultetit të Edukimit)

Përshkrimi: Edhe pse ky botim i është kushtuar studentëve të fakultetit të edukimit, mësime dhënësit në shërbim, por edhe prindërit, mund ta shfrytëzojnë si një burim përmbajtësor në gjuhën shqipe për të mësuar më shumë rreth të drejtave dhe përgjegjësi të fëmijëve. Për më shumë libri ofron strategji dhe teknika praktike të cilat mund të integrohen në klasa për të trajtuar temat që ndërlidhen me të drejtat e fëmijëve.

Ky material është botuar nga Qendra për Arsim e Kosovës, në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, në kuadër të projektit Edukimi për të Drejtat e Fëmijës.

Adresa: <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/03/Te-drejtat-e-femijes-dhe-etika-e-mesimdhenesit.pdf>

Emri i veprës: Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë

Përshkrimi: Shkollat mike për fëmijë është qasje që zbatohet në vendet e ndryshme të botës si iniciativë e UNICEF-it. Këto shkolla karakterizohen me mjedise të cilat janë të sigurta për fëmijët në kuptimin fizik, emocional e psikologjik. Edhe në Kosovë ka filluar promovimi i kësaj qasje, prandaj ky material i përgatitur nga Instituti Pedagogjik i Kosovës me mbështetjen e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, ka për qëllim ofrimin e informatave për zbatimin e kësaj praktike.

Adresa: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/standardet-per-shkollat-mike-per-femije.pdf>

Emri i veprës: Doracak për Ekipet Ndërmjetësuese mes Bashkëmoshatarëve

Përshkrimi: Doracaku shërben si udhëzues për iniciimin e ndërmjetësimin, trajnimin dhe përgatitjes së mësime dhënësit për t'i bërë nxënësit/fëmijët të aftë që të zgjidhin dallimet mes tyre në mënyrë paqësore dhe pa dhunë përmes metodave të ndërmjetësimin dhe duke zhvilluar shkaktësitë e komunikimit.

Materiali është zhvilluar në kuadër të projektit "Mbështetje drejtësisë për fëmijë" përkrahur nga zyra e BE-së në Kosovë dhe UNICEF-i, dhe është përpiluar e përshtatur nga Qendra për Arsim e Kosovës.

Adresa: <https://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/05/Doracak-p-C3%ABr-ekipet-nd-C3%ABrmjet-C3%ABsuese-n-C3%AB-mes-t-C3%AB-bashk-C3%ABmoshatar-C3%ABve.pdf>

Emri i veprës: Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit ParaUniversitar

Përshkrimi: Qeveria e Republikës së Kosovës me përkrahjen e zyrës së UNICEF-it në Kosovë ka miratuar këtë Protokoll me qëllim që të "përcaktojë detyrimet, të qartësojë rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit parauniversitar"⁴. Për më shumë, ky Protokoll synon që të nxitë bashkëpunimin në mes të institucioneve në mënyrë që të mbrohen të drejtat e fëmijëve dhe po ashtu që fëmijët të mbrohen nga dhuna.

Adresa: <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/05/Rregullore.pdf>

Emri i veprës: Udhëzues për Zbatimin e Rregullores QRK Nr. 21/2013 Për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit ParaUniversitar

Përshkrimi: Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit ParaUniversitar është përcjellur po ashtu me një udhëzues për të lehtësuar zbatimin e tij. Udhëzuesi u dedikohet të gjithë atyre që janë të përfshirë në procesin e arsimit të fëmijëve, dhe ka për qëllim që të ndihmojë në zbatimin e Protokollit duke ofruar udhëzime dhe aktivitete specifike të cilat shërbejnë si alternativa për zgjidhjen e konfliktit në mënyrë pozitive, si dhe forma për të parandaluar konfliktin para se të ndodh.

Adresa: <https://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/05/Udhezuesi-Final.pdf>

Emri i veglës: Manual Didaktik për Parandalimin e Dhunës

Përshkrimi: Save the Children po ashtu ka mbështetur realizimin e një Manuali Didaktik për Parandalimin e Dhunës, i cili shërben si vegël për ngritjen e vetëdijesimit kundër dhunës duke ofruar informata rreth zhvillimit të fëmijëve, mënyrës së shfaqjes së dhunës dhe formave se si mund të parandalohet ajo. Po ashtu, manuali ofron mësim model të cilat mund të zbatohen në klasë me grupmosha të ndryshme të nxënësve.

Adresa: <https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Didaktik%20material%20for%20prevention%20of%20violence%20ALB.pdf>

Emri i veglës: Mundësi të Barabarta në Arsim për të Gjithë

Përshkrimi: Janë dy doracakë që janë përgatitur për ekipet për parandalim dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar. Njëri u shërben ekipeve shkollore e tjetri ekipeve komunale. Doracakët janë hartuar në kuadër të projektit "Avancimi i qasjes dhe mbetjes në arsim për fëmijët e cenuar dhe në disavantazh" i zbatuar nga ECMI Kosovë dhe Zyrja e UNICEF-it në Kosovë.

Doracakët u ofron shkollave dhe komunave informata të përgjithshme, udhëzime dhe strategji për krijimin e ekipeve të cilat shërbejnë për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës nga nxënësit. Po ashtu, materialet shoqërohet me instrumente model të cilat i shërbejnë funksionimit të ekipeve shkollore, respektivisht atyre komunale.

Adresa: http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-shkollore-per-parandalim_1.pdf

Adresa: http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-komunale-per-parandalim_1.pdf

Emri i veglës: Udhëzues për Shkollat Qendra Komunitare

Përshkrimi: Ky udhëzues është përgatitur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit në Shqipëri në bashkëpunim me Save the Children. Udhëzuesi ka për qëllim që të përkrah qasjen e shkollave si qendra komunitare e cila bazohet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe nxit partneritetin në mes të shkollës, familjes dhe komunitetit, partneritet ky i cili i shërben zhvillimit të fëmijëve. Materiali ofron informata më të gjera rreth kësaj qasjeje, hapa konkretë për shndërrimin e shkollës në shkollë si qendër komunitare dhe vegla model që mund të zbatohen për promovimin e kësaj qasjeje.

Adresa: <http://myschool.al/resources/programe/doc2.pdf>

Emri i veglës: Platforma për Mbrojtjen e Fëmijëve për Evropën Juglindore

Përshkrimi: E zhvilluar në disa gjuhë, përfshirë edhe gjuhën shqipe, kjo platformë ofron materiale të shumta të cilat adresojnë mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Platforma ofron udhëzues dhe raporte të ndryshme, kurse online, materiale të përshtatura për përdorim me fëmijë, forum për shkëmbim dhe diskutim të ideve, e shumë vegla të tjera të cilat mund të shfrytëzohen për t'u informuar më shumë rreth mbrojtjes së fëmijëve, si dhe materiale që mund të përdoren gjatë punës me fëmijë.

Adresa: <https://childhub.org/sq>

Emri i veglës: Living Democracy

Përshkrimi: Faqja Living Democracy apo Demokracia në Veprim zhvilluar nga Universiteti i Edukimit të Mësuesve në Cyrih në bashkëpunim me Këshillin e Evropës ofron një numër të madh të materialeve të cilat shërbejnë për aktivitetet e mësuesdhënies dhe të nxënësve. Materialet e organizuara në gjashtë volume trajtojnë 9 koncepte kyçe si: qeveria dhe politikat, identiteti, rregullat dhe ligjet, media, konflikti, të drejtat dhe liria, diversiteti dhe pluralizmi, përgjegjësia, barazia. Qëllimi i kësaj faqeje është që të zhvillojë demokracinë dhe të drejtat e njeriut në shkollë⁵ duke ofruar udhëzime për ndërmarrjen e hapave konkretë për realizim në klasë.

Adresa: <http://www.living-democracy.al/>

Emri i veglës: Të Eksplorojmë të Drejtat e Fëmijëve.

Përshkrimi: Ky është njëri ndër volumet e publikuara në faqen Living Democracy që lidhet drejtpërdrejt me të drejtat e fëmijëve dhe ofron mësim model për klasat 1-9, informata të përgjithshme në lidhje me Konventën dhe dokumente e materiale të tjera që lidhen me të drejtat e fëmijëve.

Adresa: <http://www.living-democracy.al/textbooks/volume-5/>

Emri i veglës: Through the Wide Web Woods

Përshkrimi: Lojë online e cila është zhvilluar nga Këshilli i Evropës për t'i ndihmuar fëmijët që të mësojnë rregullat kryesore të sigurisë në Internet. Përveç kësaj, loja promovon konceptet si demokracia, respekti për të tjerët dhe të drejtat e fëmijëve. Këtë lojë mund ta bëni pjesë të ndonjë ore mësimore që mund ta realizoni në kabinet të informatikës si aktivitet ekstrakurrikular apo ta ndani me nxënësit që ata ta luajnë jashtë procesit mësimor dhe ta përcillni me diskutime në klasë. Për mësuesdhënësit është përgatitur udhëzuesi që mund të shkarkohet nga ueb faqja.

Pasi që ta hapni faqen dhe të klikoni në emrin e lojës që paraqitet në faqe mund të përzgjidhni opsionin për ta luajtur lojën edhe në gjuhën shqipe. Mund t'ju kërkohet ta shkarkoni apo ta lejoni Adobe Flash Player, duke klikuar në ikonën respektive.

Adresa: <https://www.coe.int/en/web/children/through-the-wild-web-woods>

Këtu janë përmbledhur disa vegla në gjuhën angleze të cilat mund të përshtaten për përdorim në gjuhën shqipe.

Emri i veglës: Compass - Manual for Human Rights Education with Young People

Përshkrimi: Në këtë faqe të Këshillit të Evropës jepet një udhëzues që mund të përdoret për edukimin për të drejtat e njeriut me të rinj. Compass është i përshtatshëm për përdorim si në mjediset e të mësuarit joformal me të rinj të organizatave rinore, ashtu edhe në shkollat me nxënës të shkollave të mesme të larta. Manuali ofron një varg aktivitetesh që mbështeten në të mësuarit përmes përvojës dhe trajtojnë tema të shumta që lidhen me aspekte të të drejtave të njeriut.

Duke klikuar në butonin "Resources" në këtë ueb faqe, hapet një listë e burimeve tjera, ndër të cilat Compasito është manual i njëjtë me Compass, por që është i përshtatshëm për përdorim me fëmijë.

Adresa: <http://www.coe.int/en/web/compass/home>

Emri i veglës: Rights Respecting Schools - Classroom Charters

Përshkrimi: Në këtë faqe mund të gjeni një material të përgatitur nga UNICEF në Kanada i cili ofron ide për krijimin e Statutit të Klasës i cili përdoret si praktikë për t'i bërë të drejtat e fëmijëve më kuptimplote dhe domethënëse për nxënësit.

Ky Statut mund të përdoret si aktivitet për t'i nxitur nxënësit që të mendojnë dhe diskutojnë më shumë rreth të drejtave të tyre dhe po ashtu si një artefakt që mund të bëhet pjesë e klasës për t'iu referuar sa herë që është e nevojshme.

Adresa: <https://rrscanada.files.wordpress.com/2013/09/classroom-charters.pdf>

5 <http://www.living-democracy.al/>

Emri i veprës: Filma vizatimorë

Përshkrimi: UNICEF ka përgatitur një numër të filmave vizatimorë të cilët ndërlidhen me nenet e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Këto video mund të përdoren nga mësuesit dhe prindërit me grupmosha të ndryshme të nxënësve/fëmijëve për të nxitur diskutimin rreth të drejtave të fëmijëve, si materiale shtesë për aktivitetet që zhvillohen me nxënësit për të promovuar të drejtat e fëmijëve apo edhe për të nxitur nxënësit që të krijojnë materialet e tyre promovuese. Kjo faqe po ashtu përmban materiale të tjera të cilat nxisin të rinjtë të mendojnë më shumë rreth kësaj teme, por edhe të ndërmarrin vetiniciativa konkrete për të promovuar të drejtat e fëmijëve duke u bërë kështu pjesë e rrjetit të të rinjve nga vendet e ndryshme që punojnë në këtë drejtim.

Adresa: https://www.unicef.org/rightsite/433_cartoons.php

Emri i veprës: Kids Go Global

Përshkrimi: Kjo platformë u dedikohet nxënësve të shkollës fillore e të mesme dhe ofron mundësi që nxënësit të eksplorojnë temat që kanë të bëjnë me çështje globale duke përfshirë edhe të drejtat e njeriut. Platforma përmban burime të ndryshme dhe përfshinë kurse online, burime që mund të përdoren në klasë nga mësuesit, shembuj të punës së të rinjve dhe projekte të ndryshme shkollore.

Mësuesit dhe prindërit mund t'i shfrytëzojnë burimet e kësaj platforme për të trajtuar temën e të drejtave të njeriut e të drejtave të fëmijëve, t'u sugjerojnë fëmijëve/nxënësve që ata vet ta përdorin këtë platformë, apo ta përdorin si inspirim për të zbuluar dhe ndërmarrë iniciativa të ndryshme me nxënës/fëmijë.

Adresa: <http://www.kidsglobal.net/the-issues/human-rights/>

Emri i veprës: Burime për shkollimin e hershëm dhe shkollat fillore nga Amnesty International

Përshkrimi: Kjo faqe ofron një numër të konsiderueshëm të materialeve në lidhje me të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e fëmijëve për grupmoshat e ndryshme, duke filluar nga fëmijëria e hershme deri në moshën 11 vjeçare. Burimet vijnë në forma të ndryshme duke përfshirë libra të ndryshëm, posterë, video e paketa për mësime.

Adresa: <https://www.amnesty.org.uk/primary-schools-education-resources>

Emri i veprës: Rights Respecting Schools - Teaching Resources

Përshkrimi: Në këtë ueb faqe mund të gjeni një mori burimesh mësimore për grupmosha të ndryshme të cilat kanë në fokus të drejtat e fëmijëve. Ide për integrimin e temës së të drejtave të fëmijëve në lëndët e ndryshme mësimore, aktivitete shtesë që mund të realizoni me nxënës, kalendari i ditëve të veçanta, praktikat më të mira të zbatuara në vende të ndryshme janë vetëm disa burimet që mund t'i gjeni këtu.

Adresa: <https://rightsrespectingschools.ca/teaching-resources-schools/>

Emri i veprës: It's Only Right

Përshkrimi: Një tjetër material i përgatitur nga UNICEF në Kanada për t'u përdorur me nxënës/fëmijë në mënyrë që t'i ndihmojmë ata të kuptojnë më mirë Konventën e të Drejtave të Fëmijëve përmes aktiviteteve. Faqja po ashtu ofron ide për ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga vet fëmijët/nxënësit.

Adresa: <http://www.unicef.ca/en/our-work/article/its-only-right>

Emri i veglës: Twenty One Assemblies for Primary Schools

Përshkrimi: Materiali në vijim është publikuar nga UNICEF në Mbretërinë e Bashkuar dhe u dedikohet shkollave fillore. Ky burim ofron aktivitete të ndryshme dhe mësim model për të trajtuar të drejtat e fëmijëve gjatë ditëve të veçanta si Dita e Mësimdhënësve, Dita e Librit, Dita e Fëmijëve, e kështu me radhë.

Adresa: https://www.unicef.org.uk/rights-respecting-schools/wp-content/uploads/sites/4/2016/09/primary_assemblies_unicef.pdf

Emri i veglës: Linking Events to Rights

Përshkrimi: Një tjetër burim nga UNICEF ku bëhet ndërlidhja në mes të ditëve të rëndësishme që shënohen në botë dhe neneve nga Konventa për të drejtat e fëmijës.

Adresa: <https://www.unicef.org.uk/rights-respecting-schools/linking-events-rights/>

Emri i veglës: Thinking Rights: Secondary School Resource Pack

Përshkrimi: Ky burim nga UNICEF në Mbretërinë e Bashkuar u dedikohet nxënësve të shkollave të mesme. Qëllimi i këtij burimi është që të inkurajojë zhvillimin e koncepteve dhe shkathtësive të të rinjve rreth mënyrës se si ata mendojnë për të drejtat e njeriut.

Adresa: <https://www.unicef.org.uk/rights-respecting-schools/resources/thinking-rights-secondary-school-resource/>

Emri i veglës: Children's Rights Develop English Skills with 8 - 11 year olds Oxfam

Përshkrimi: Materiali në vijim është përpiluar për të mbështetur dhe zhvilluar shkathtësitë e leximit, shkrimit dhe të folurit për kurrikulën e gjuhës angleze në Britani duke trajtuar në të njëjtën kohë tema që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Materiali mund të përshtatet lehtë për përdorim në lëndën e gjuhës angleze.

Adresa: <http://www.oxfam.org.uk/education/resources/childrens-rights>

Emri i veglës: How to Create Child Friendly Environments - Guide Book

Përshkrimi: Ky udhëzues i përkrahur nga UNICEF ofron informacione për përkujdesje të vazhdueshme e cila shërben në zhvillimin kognitiv të fëmijëve dhe mënyrave se si mund të krijohen mjedise të përshtatshme dhe të sigurta për rritjen e fëmijëve. Udhëzuesi që trajton fëmijërinë e hershme u dedikohet kryesisht prindërve, por mund të shfrytëzohet edhe nga personat e tjerë të pranishëm në fëmijërinë e hershme të fëmijëve, përfshirë edukatorët në institucionet parashkollore. Udhëzuesi, përveç informatave, shoqërohet me ilustrime dhe ide praktike për krijimin e lojërave të ndryshme të cilat stimulojnë zhvillimin e fëmijëve.

Adresa: <https://www.unicef.org/bangladesh/ChildFE.pdf>

Shënim:

Për shkak se interneti është shumë dinamik shumë shpesh një link mund të zhvendoset në një hapësirë tjetër apo të mos funksionojë më. Në rast se ndonjëri prej linqeve nuk funksionon provoni të kërkoni në Google (apo ndonjë makinë tjetër kërkuese) emrin e veglës që është dhënë në këto faqe.

Për t'iu qasur më lehtë këtyre veglave mund të shfrytëzoni manualin që keni në dispozicion në formë elektronike përmes adresës <http://www.childrights-ks.org/> dhe pastaj mund t'iu qasni burimeve me një klikim.

8. Karakteristikat e shkollës mike të bazuar në të drejtat e fëmijëve

- 1. Reflekon dhe respekton të drejtat e çdo fëmije** - bashkëpunon me partnerë të tjerë për të promovuar dhe monitoruar mirëqenien dhe të drejtat e të gjithë fëmijëve; mbron dhe ruan të gjithë fëmijët nga abuzimi dhe lëndimi brenda dhe jashtë shkollës.
- 2. Sheh dhe kupton fëmijën në tërësi, në një kontekst të gjerë** - interesohet për gjendjen e fëmijëve para se ata të hyjnë në sistemin e shkollës (p.sh. gatishmëria e tyre për shkollë në aspektin e gjendjes shëndetësore dhe ushqyese, aftësitë sociale dhe gjuhësore), dhe pasi që të përfundojnë shkollimin -- në shtëpitë e tyre, komunitet dhe punë.
- 3. Është e fokusuar në fëmijë** - inkurajon pjesëmarrjen, kreativitetin, vetëbesimin dhe mirëqenien psiko-fizike; promovon kurrikulë të strukturuar dhe të fokusuar në fëmijë dhe metoda të mësimit të cilat janë të përshtatshme me nivelin e zhvillimit të fëmijëve, aftësitë dhe preferencat e tyre për të nxënë; po ashtu vendos në rend të parë nevojat e fëmijëve karshi nevojave të personave të tjerë të përfshirë në sistem.
- 4. Është e ndjeshme kundrejt gjinisë dhe ofron ambient mik për vajza** - promovon barazi gjatë regjistrimit të vajzave dhe djemve; zvogëlon faktorët që kufizojnë barazinë gjinore dhe eliminon stereotipat gjinorë; siguron pajisje, kurrikula dhe procese mësimesore të cilat mirëpresin vajzat.
- 5. Promovon rezultate cilësore të të nxënësve** - inkurajon nxënësit që të mendojnë në mënyrë kritike, të bëjnë pyetje, të shprehin mendimet e tyre dhe të mësojnë se si të mësojnë; ndihmon fëmijët që të zotërojnë shkathtësitë themelore të leximit, shkrimit, të folurit, dëgjimit, matematikës dhe njohuritë e shkathtësitë e përgjithshme të shekullit, duke përfshirë njohuritë tradicionale dhe vlerat për paqe, demokraci dhe pranim të diversitetit.

6. Siguron edukim të bazuar në realitetin e jetës së fëmijëve - sigurohet që përmbajtja kurrikulare t'i përgjigjet nevojave të të nxënësve të secilit fëmijë individualisht dhe po ashtu objektivave të përgjithshme të sistemit arsimor, kontekstit lokal dhe njohurive tradicionale për familje dhe komunitet.

7. Është fleksibile dhe i përgjigjet diversitetit - plotëson nevojat dhe rrethanat e ndryshme të fëmijëve (p.sh. siç përcaktohen për nga gjinia, kultura, klasa shoqërore, niveli i aftësive)

8. Vepron për të siguruar gjithëpërfshirje, respekt dhe mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët - nuk ka stereotipa, nuk përjashton apo diskriminon në bazë të dallimeve.

9. Promovon shëndetin mendor dhe fizik - siguron mbështetje emocionale, inkurajon sjellje dhe praktika të shëndetshme dhe garanton një mjedis të pastër, të sigurt, mbrojtës dhe gazmor.

10. Siguron edukim të qashtë dhe të përballueshëm - veçanërisht për fëmijët dhe familjet që janë më së shumti të rrezikuara.

11. Përmirëson kapacitetin, disiplinën, përkushtimin dhe statusin e mësimit - sigurohet që të gjithë mësuesit t'u ofrohet trajnim i mjaftueshëm para shërbimit dhe mbështetje, zhvillim profesional, status dhe të ardhura gjatë shërbimit.

12. Fokusohet në familje - bën përpjekje që të punojë me familjet, t'i fuqizojë ato dhe të ndihmojë fëmijët, prindërit dhe mësuesit që të krijojnë raporte bashkëpunuese që karakterizohen me harmoni.

13. Bazohet në komunitet - fuqizon udhëheqjen e shkollës përmes një qasjeje të decentralizuar dhe të bazuar në komunitet; inkurajon prindërit, qeverisjen lokale, organizatat e komunitetit dhe institucionet tjera të shoqërisë civile që të marrin pjesë në menaxhim dhe financimin e arsimit; promovon partneritet me komunitetin dhe krijon rrjet i cili bazohet në të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve.

Këto karakteristika janë përshtatur nga dokumenti udhëzues i UNICEF-it i cili u shërben shkollave për të promovuar qasjen e shkollave mike për fëmijë.

9. Të reflektojmë rreth shkollës

Mësimitdhënësit dhe prindërit mund ta plotësojnë vlerësimin në mënyrë të pavarur (individualisht) dhe më pas ta përdorin si pikë referimi për diskutim. Por, vlerësimi mund të bëhet edhe bashkërisht nga mësimitdhënësit dhe prindërit, duke ofruar mundësi për diskutim dhe shkëmbim idesh në të njëjtën kohë.

Vlerësimi shërben për të reflektuar mbi praktikat aktuale të shkollës nga ana e mësimitdhënësve dhe prindërve. Më pas, bazuar në reflektim dhe përmes bashkëpunimit prindër-mësimitdhënës mund të planifikohen hapa konkretë për ndërmarrjen e iniciativave që u shërbejnë të drejtave të fëmijëve dhe rrjedhimisht ndikojnë në ngritjen e vetëdijes në shkollë për një shkollë mike për fëmijët.

Kjo fletë vlerësuese është përgatitur bazuar në standardet e Shkollave Mike për Fëmijë, të promovuara nga UNICEF.

Të gjithë nxënësit në shkollë trajtohen në mënyrë të barabartë.

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

Nxënësit ndihen të sigurt në shkollë.

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

Shkolla ofron mekanizma për identifikimin e nevojave dhe vështirësive të nxënësve dhe ndërmarrjen e hapave konkretë për përmbushjen/tejkalimin e tyre.

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

Nxënësit kanë të drejtë dhe inkurajohen të shprehin mendimin e tyre si gjatë aktiviteteve mësimore ashtu edhe jashtë tyre.

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

Shkolla përfshin nxënësit në vendimmarrje në lidhje me proceset që ndikojnë drejtpërdrejtë te ata.

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

Prindërit janë të përfshirë në vendimmarrje për çështjet e jetës shkollore.

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

Shkolla ofron mekanizma për përkrahjen e nxënësve në zhvillimin e potencialeve të tyre.

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

Shkolla bashkëpunon me prindërit dhe komunitetin për të arritur zhvillimin maksimal dhe mbrojtjen e interesit më të mirë të nxënësve.

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

Shkolla u ofron nxënësve mundësi për të përforcuar vlerat e qytetarisë (p.sh. respekti, toleranca, solidariteti, etj.).

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

Shkolla ka procedura të qarta rreth përkujdesjes për shëndetin fizik e psikik të nxënësve.

Nuk pajtohem aspak ① ② ③ ④ ⑤ Pajtohem plotësisht

10. Përmbledhje e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve

NENI 1 (përkufizimi i fëmijës)

Çdo person nën moshën 18 vjeçare i gëzon të gjitha të drejtat në Konventë.

NENI 2 (mos diskriminimi)

Konventa vlen për çdo fëmijë pa dallim, pavarësisht etnitetit, gjinisë, fesë, gjuhës dhe aftësive të tyre apo çfarëdo statusi tjetër, pa marrë parasysh si mendojnë ata apo çfarë thonë dhe pavarësisht origjinës së prindërve të tyre.

NENI 3 (interesat me të mira të fëmijës)

Interesat më të mira të fëmijës duhet të jenë prioritet në të gjitha vendimet dhe veprimet që ndërmerren të cilat kanë ndikim në fëmijët.

NENI 4 (zbatimi i Konventës)

Qeveritë duhet të ndërmarrin të gjitha masat që kanë në fuqi për të krijuar sisteme dhe miratuar ligje të cilat promovojnë dhe

mbrojnë të drejtat e fëmijëve në mënyrë që të sigurohen që të gjithë fëmijët gëzojnë të drejtat e tyre.

NENI 5 (udhëzimet e prindërve dhe kapacitetet e zhvillimit të fëmijës)

Qeveritë duhet të respektojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve apo kujdestarëve tjerë të fëmijëve për të udhëzuar dhe drejtuar fëmijën e tyre gjatë rritjes në mënyrë që fëmija t'i gëzojë plotësisht të drejtat e saj/tij. Kjo duhet të bëhet duke pranuar kapacitetin në zhvillim e sipër të fëmijës për të marrë vendimet e tij/saj.

NENI 6 (jeta, mbijetesa dhe zhvillimi)

Çdo fëmijë gëzon të drejtën për të jetuar. Qeveritë duhet të bëjnë çdo gjë që është në fuqinë e tyre për t'u siguruar që fëmijët mund të mbijetojnë dhe të zhvillohen në potencialin e plotë të tyre.

NENI 7 (regjistrimi i lindjes, emri, kombësia dhe kujdesi)

Çdo fëmijë gëzon të drejtën që të regjistrohet pas lindjes, të ketë një emër dhe kombësi, të njoh dhe të ketë përkujdesjen e prindërve.

NENI 8 (mbrojtja dhe ruajtja e identitetit)

Çdo fëmijë ka të drejtën të ketë një identitet. Qeveritë duhet të respektojnë e të mbrojnë këtë të drejtë dhe të parandalojnë ndryshimin e paligjshëm të emrit të fëmijës, kombësisë apo lidhjeve familjare.

NENI 9 (ndarja nga prindërit)

Fëmijët nuk duhet të ndahen nga prindërit pa dëshirën e tyre përveç nëse është në interesin e tyre më të mirë (për shembull nëse prindërit lëndojnë apo nuk kujdesen si duhet për fëmijën). Fëmijët, prindërit e të cilëve janë ndarë, kanë të drejtën të jenë në kontakt me të dy prindërit, përveç në rastet kur kjo u shkakton dëm.

NENI 10 (ribashkimi i familjes)

Qeveritë duhet të përgjigjen shpejt dhe me mirësi në rastet kur një fëmijë ose prindërit e saj/tij aplikojnë për të jetuar së bashku në të njëjtin shtet. Nëse prindërit e një fëmije jetojnë të ndarë në shtete të ndryshme, fëmija ka të drejtë t'i vizitojë dhe të mbajë kontakte me të dy prindërit.

NENI 11 (rrëmbimi dhe moskthimi i fëmijëve)

Qeveritë duhet të bëjnë çdo gjë që është në fuqinë e tyre që të parandalojnë largimin e paligjshëm të fëmijëve nga shteti i tyre ose moslejimin e kthimit në shtëpinë e tyre çoftë nga prindërit e tyre apo të afërmit e tjerë.

NENI 12 (respektimi i pikëpamjeve të fëmijës)

Çdo fëmijë ka të drejtë të shpreh pikëpamjet, ndjenjat dhe dëshirat e tij/saj për të gjitha çështjet që lidhen me të, dhe pikëpamjet e tij/saj duhet të merren parasysh dhe të merren seriozisht. Kjo e drejtë zbatohet gjithmonë, për shembull gjatë procesit të imi-

grimit, vendimeve që merren rreth banimit apo jetës së përditshme të fëmijës.

NENI 13 (e drejta e shprehjes)

Çdo fëmijë duhet të jetë i lirë të shpreh mendimet dhe opinionet e saj/tij dhe të ketë qasje në të gjitha informatat, përderisa ato informata janë në përputhje me ligjin.

NENI 14 (e drejta e mendimit, besimit dhe fesë)

Çdo fëmijë ka të drejtë të mendojë dhe besojë sipas zgjedhjes së tij/saj dhe po ashtu të praktikojë fenë e tij/saj përderisa kjo nuk pengon njerëzit e tjerë të gëzojnë të drejtat e tyre. Qeveritë duhet të respektojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve për të udhëzuar fëmijën e tyre gjatë rritjes së saj/tij.

NENI 15 (liria e bashkimit)

Çdo fëmijë ka të drejtë të takojë fëmijët e tjerë dhe të bëhet pjesë e grupeve dhe organizatave, përderisa kjo nuk i pengon të tjerët për të gëzuar të drejtat e tyre.

NENI 16 (e drejta e intimitetit)

Çdo fëmijë ka të drejtën e intimitetit. Ligji duhet të mbrojtë jetën private, familjare dhe në shtëpi duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve nga sulmet e paligjshme që dëmtojnë reputacionin e tyre.

NENI 17 (qasja në informatat nga mediat)

Çdo fëmijë ka të drejtën të ketë qasje në informata të besueshme nga burimet e ndryshme dhe qeveritë duhet të inkurajojnë mediat që të paraqesin informata që janë të kuptueshme për fëmijë. Qeveritë duhet të ndihmojnë në mbrojtjen e fëmijëve nga materialet që mund t'i dëmtojnë ata.

NENI 18 (përgjegjësitë e prindërve dhe ndihma nga shteti)

Të dy prindërit ndajnë përgjegjësi për rritjen e fëmijës së tyre dhe gjithmonë duhet të marrin për bazë atë që është më e mira për fëmijën. Qeveritë duhet të mbështesin prindërit duke krijuar shërbime për fëmijë dhe duke u ofruar prindërve ndihmën që u nevojitet për të rritur fëmijët e tyre.

NENI 19 (mbrojtja nga dhuna, abuzimi dhe mospërfillja)

Qeveritë duhet të bëjnë çdo gjë që është në fuqinë e tyre për t'u siguruar që fëmijët janë të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, mospërfilljes dhe keqtrajtimit nga prindërit e tyre apo persona të tjerë që kujdesen për ta.

NENI 20 (fëmijët që e kanë të pamundur të jetojnë me familjet e tyre)

Nëse familja e ngushtë nuk mund të kujdeset për një fëmijë, qeveria duhet t'i ofrojë atij/asaj mbrojtje dhe ndihmë të veçantë. Fëmijës duhet t'i sigurohet përkujdesje e vazhdueshme alternative që respekton kulturën, gjuhën dhe fenë e fëmijës.

NENI 21 (adoptimi)

Qeveritë duhet të mbikëqyrin procesin e adoptimit në mënyrë që të sigurohen se është i sigurt, i ligjshëm dhe që vë në mend të parë interesat me të mira të fëmijëve. Fëmijët duhet të adoptohen jashtë shtetit të tyre vetëm kur nuk mund të vendosen në një familje në shtetin e tyre.

NENI 22 (fëmijët refugjatë)

Nëse një fëmijë kërkon strehim apo ka status refugjati atëherë qeveritë duhet t'i ofrojnë asaj/atij mbrojtjen dhe ndihmën e duhur për të gëzuar të gjitha të drejtat e Konventës. Qeveritë duhet të ndihmojnë fëmijët refugjatë të ribashkohen me prindërit e tyre në rast që janë ndarë.

NENI 23 (fëmijët me nevoja të veçanta)

Një fëmijë që ka nevoja të veçanta ka të drejtë të jetoj një jetë të mirë, me dinjitet, aq sa është e mundur në mënyrë të pavarur, dhe të luaj një rol aktiv në komunitet. Qeveritë duhet të bëjnë çdo gjë që është në fuqinë e tyre për të mbështetur fëmijët me nevoja të veçanta dhe familjet e tyre.

NENI 24 (shëndeti dhe shërbimet shëndetësore)

Çdo fëmijë ka të drejtë të gëzojë shëndetin më të mirë të mundshëm. Qeveritë duhet të ofrojnë kujdes shëndetësor të cilësisë së mirë, ujë të pastër, ushqim të shëndetshëm, mjedis të pastër dhe edukim mbi shëndetin dhe mirëqenien në mënyrë që

fëmijët të jenë të shëndetshëm. Vendet më të pasura duhet të ndihmojnë vendet më të varfra që të arrijnë këtë.

NENI 25 (vlerësimi i mënyrës së trajtimit të fëmijës kur është nën përkujdesje jashtë familjes së tij/saj)

Nëse një fëmijë është larguar nga shtëpia për qëllim të përkujdesjes apo mbrojtjes (për shembull me familje kujdestare apo në spital) ata gëzojnë të drejtën që të vlerësohet vazhdimisht mënyra se si fëmijët po trajtohen dhe rrethanat e tjera.

NENI 26 (sigurimi social)

Çdo fëmijë ka të drejtën që të përfitojë nga sigurimi social. Qeveritë duhet të ofrojnë sigurim social, duke përfshirë mbështetje financiare dhe përfitime të tjera për familjet në nevojë.

NENI 27 (standardi i duhur i jetesës)

Çdo fëmijë ka të drejtën e standardit të jetesës i cili është mjaftueshëm e mirë për të plotësuar nevojat e tyre fizike dhe shoqërore dhe për të mbështe-

tur zhvillimin e tyre. Qeveritë duhet të ndihmojnë familjet të cilat nuk janë në gjendje ta ofrojnë këtë.

NENI 28 (e drejta për arsimim)

Çdo fëmijë ka të drejtën për arsimim. Arsimi fillor duhet të jetë pa pagesë dhe format e ndryshme të arsimit të mesëm duhet të jenë në dispozicion për secilin fëmijë. Disiplina në shkollë duhet të respektojë dinjitetin e fëmijëve dhe të drejtat e tyre. Shtetet më të pasura duhet të ndihmojnë shtetet më të varfra që të arrijnë këtë.

NENI 29 (qëllimet e arsimimit)

Arsimi duhet të zhvillojë personalitetin, talentin dhe aftësitë e secilit fëmijë në potencialin e plotë të saj/tij. Duhet të inkurajojë fëmijën që të respektojë të drejtat e njeriut, kulturën e tij/saj dhe të tjerëve, dhe mjedisin.

NENI 30 (fëmijët nga grupet pakicë apo indigjenë)

Çdo fëmijë ka të drejtë që të mësojë dhe të përdorë gjuhën, zakonet dhe fenë e familjes së tij/saj, pa marrë parasysh se a janë

këto të njëjta me shumicën e njerëzve në shtetin ku jetojnë.

NENI 31 (koha e lirë, loja dhe kultura)

Çdo fëmijë ka të drejtë të relaksohet, të luajë dhe të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike.

NENI 32 (puna e fëmijëve)

Qeveritë duhet të mbrojnë fëmijët nga shfrytëzimi ekonomik dhe puna që është e rrezikshme apo mund të dëmtojë shëndetin, zhvillimin dhe arsimimin e tyre. Qeveritë duhet të përcaktojnë një moshë minimale kur fëmijët mund të fillojnë të punojnë dhe të sigurohen që kushtet e punës janë të sigurta dhe të duhurat.

NENI 33 (abuzimi me narkotikë)

Qeveritë duhet të mbrojnë fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i substancave narkotike dhe nga përfshirja e tyre në prodhimin dhe shpërndarjen e narkotikëve.

NENI 34 (shfrytëzimi seksual)

Qeveritë duhet të mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual).

NENI 35 (rrëmbimi, shitja dhe trafikimi)

Qeveritë duhet të mbrojnë fëmijët nga rrëmbimi, shitja apo lëvizja e paligjshme në një vend tjetër jashtë apo përbrenda vendit të tyre për qëllime shfrytëzimi.

NENI 36 (format e tjera të shfrytëzimit)

Qeveritë duhet të mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e shfrytëzimit, për shembull shfrytëzimi i fëmijëve për aktivitete politike, nga mediat apo për hulumtime mjekësore.

NENI 37 (trajtimi johuman dhe ndëshkimi)

Fëmijët nuk duhet të torturohen, të dënohen me vdekje apo të vuajnë nga format e tjera ndëshkuese dhe degraduese. Arrestimi, burgimi apo mbajtja në paraburgim e fëmijëve duhet të përdoren si mjeti i fundit dhe për kohën më të shkurtër të mundshme. Fëmijët duhet të trajtohen me respekt dhe kujdes dhe të lejohen të mbajnë kontakte me familjen e tyre. Fëmijët nuk duhet të vendosen në burgje me të rritur.

Konventa ka 54 artikuj gjithsej. Artikujt 43 - 54 kanë të bëjnë me mënyrën se si të rriturit dhe qeveritë duhet të punojnë së bashku për t'u siguruar që të gjithë fëmijët gëzojnë të drejtat e tyre.

NENI 38 (lufta dhe konfliktet e armatosura)

Qeveritë nuk duhet të lejojnë fëmijët nën moshën 15 vjeçare të marrin pjesë në luftë apo t'i bashkohen forcave të armatosura. Qeveritë duhet të bëjnë çdo gjë që është në fuqinë e tyre që të mbrojnë dhe të përkujdesen për fëmijët e ndikuar nga lufta dhe konfliktet e armatosura.

NENI 39 (shërimi nga trauma dhe riintegrimi)

Fëmijëve të cilët kanë përjetuar mospërfillje, abuzim, shfrytëzim, torturë apo të cilët janë viktimë të luftës duhet t'u ofrohet mbështetje të veçante për t'i ndihmuar ata që të rikthejnë shëndetin e tyre, dinjitetin, vetrespektin dhe jetën shoqërore.

NENI 40 (drejtësia për të mitur)

Një fëmijë i akuzuar apo fajtor për

shkeljen e ligjit duhet të trajtohet me dinjitet dhe respekt. Fëmijët kanë të drejtën e ndihmës ligjore dhe gjyqit që e merr parasysh moshën e tyre. Qeveritë duhet të përcaktojnë moshën minimale kur fëmijët mund të trajtohen në gjyq kriminal dhe të menaxhojnë një sistem gjyqësor që u mundëson fëmijëve të cilët kanë qenë në konflikt me ligjin të riintegrohen në shoqëri.

NENI 41 (respektimi për standarde më të larta kombëtare)

Nëse një shtet ka ligje apo standarde të cilat shkojnë përtej Konventës aktuale, atëherë shteti duhet t'i mbaj ato ligje.

NENI 42 (njohja e të drejtave)

Qeveritë duhet të punojnë në mënyrë aktive që të sigurohen që fëmijët dhe të rriturit të njohin dhe të dinë për Konventën.



**Adaptuar nga Përmbledhja mbi të Drejtat e Fëmijëve të publikuar nga UNICEF në Mbretërinë e Bashkuar.*

Versioni origjinal i këtij përkthimi mund të gjendet në këtë vegëz:

<https://www.unicef.org.uk/what-we-do/un-convention-child-rights/?gclid=Cj0KEQjwnazLBRDxrdG-Mx-Km4oQBElQAQJ1q63OsrQWALg--BL3zP5CUfC2EUDkMpwHBmdx10nQs6eAaAs918P8HAQ&sisr=1>